



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

Nr. 318 Akti

Nr. 392 Vendimi
Tiranë, më 28.5.2021

V E N D I M

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

Roland Ilia	Kryesues
Etleda Çiftja	Relatore
Alma Faskaj	Anëtare

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Olsida Goxhaj, me praninë edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në datat 26.5.2021, ora 10:00 dhe 28.5.2021, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mbylli seancën dëgjimore mbi çështjen që i përket:

SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT: **Znj. Natasha Prifti (Shallapi)**, me detyrë prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

OBJEKTI: **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

BAZA LIGJORE: **Neni 179/b i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë** dhe nenet Ç, D, DH, E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë;

Ligji nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

Ligji nr. 44/2015, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

Ligji nr. 49/2012, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”, i ndryshuar.

KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT,

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, komisionere Etleda Çiftja, mori në shqyrtim dhe analizoi provat shkresore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit kryesisht, dëgjoi subjektin e rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi), pasi shqyrtoi në tërësinë e saj çështjen që i përket subjektit të rivlerësimit, i cili në seancë dëgjimore publike kërkoi konfirmimin në detyrë, si dhe bisedoi çështjen në tërësi,

V Ë R E N:

I. RRETHANAT PROCEDURALE

1. Znj. Natasha Prifti (Shallapi) është subjekt i rivlerësimit për shkak të funksionit të saj si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë bazuar në nenin 179/b, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, ‘Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë’, të ndryshuar”, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim ligji nr. 84/2016).
2. Znj. Natasha Prifti (Shallapi), bazuar në nenin 14 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i është nënshtruar procesit të rivlerësimit, duke u shortuar në datën 12.11.2019, me trupin gjykues të përbërë nga komisionerët: Alma Faskaj, Etleda Çiftja dhe Roland Ilia.
3. Menjëherë pas hedhjes së shortit u administruan raportet e vlerësimit të hartuara nga: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim ILDKPKI), sipas neneve 31 - 33, të ligjit nr. 84/2016; Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim DSIK), sipas neneve 34 - 39, të ligjit nr. 84/2016; dhe, më tej, nga Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim KLP), sipas neneve 40 - 44, të ligjit nr. 84/2016.
4. Trupi gjykues i shortuar në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit (në vijim Komisioni), me vendimin e datës 29.11.2020, pas studimit të raporteve të sipërpërmendura të vlerësimit të hartuara nga institucionet shtetërore, vendosi të fillojë hetimin administrativ të thellë dhe të gjithanshëm, sipas nenit 45 të ligjit nr. 84/2016, me qëllim vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, si dhe të caktojë kryesuese të trupit gjykues komisionerin Roland Ilia. Të gjithë anëtarët deklaruan mosqenien në kushtet e konfliktit të interesit.
5. Në datën 3.12.2019, përmes postës elektronike¹, trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit: mbi vendimin e trupit gjykues të datës 29.11.2019, për fillimin e procesit të rivlerësimit; mbi përbërjen e trupit gjykues; si dhe i kërkoi subjektit të deklaronte nëse gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me anëtarët e trupit gjykues. Komisioni, gjithashtu, i kërkoi subjektit informacion shtesë sipas pyetësorit standard.
6. Nga momenti i fillimit të hetimit, Komisioni ka komunikuar me subjektin me anë të postës elektronike, duke i kërkuar shpjegime dhe prova lidhur me procesin e rivlerësimit.

¹E-mail datë 3.12.2019, ora 10:33, “Njoftim për fillimin e procesit të rivlerësimit dhe kërkesë për informacion shtesë”.

7. Trupi gjykues, me vendimin e datës 2.3.2021, vendosi: (i) të përfundojë hetimin paraprak për subjektin e rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi), bazuar në relatimin mbi rezultatet e hetimit të paraqitur nga relatori i çështjes; (ii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi rezultatet e hetimit kryesisht sipas ligjit nr. 84/2016, të drejtën për të paraqitur prova/shpjegime me shkrim në lidhje me rezultatet e hetimit; (iii) të njoftojë subjektin e rivlerësimit për t'u njohur me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, si dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40 të Kodit të Procedurave Administrative; (iv) të njoftojë subjektin e rivlerësimit mbi të drejtat që gëzon nga ligji për të kërkuar marrjen e provave të tjera ose thirrjen e dëshmitarit, si dhe me afatin brenda të cilit mund t'i ushtrojë këto të drejta.

8. Në datën 2.3.2021, përmes postës elektronike², trupi gjykues njoftoi subjektin e rivlerësimit mbi: (i) rezultatet e hetimit kryesisht; (ii) kalimin e barrës së provës, sipas nenit 52, të ligjit nr. 84/2016 dhe të sjellë prova për të provuar të kundërtën, jo më vonë se data 12.3.2020; (iii) njohjen me provat e administruara nga Komisioni, në përputhje me nenin 47, të ligjit nr. 84/2016, dhe me nenet 45 - 47 dhe 35 - 40, të Kodit të Procedurave Administrative.

9. Sa më sipër, subjekti i rivlerësimit, me anë të postës elektronike³ lidhur me rezultatet e hetimit, kërkoi shtyrjen e afatit për një periudhë kohe prej 6 muajsh, pasi ndodhej në fund të muajit të nëntë të shtatzënisë dhe e kishte të pamundur të paraqiste prapësimet. Për sa rezultoi, trupi gjykues, bazuar në nenin 104 të Kodit të Punës, vendosi që subjekti i rivlerësimit të paraqesë prapësimet brenda javës së parë të mbarimit të 63 ditëve, pra, deri në datën 17.5. 2021, vendim i cili iu komunikua me anë të postës elektronike⁴.

10. Në datat 17.5.2021 dhe 19.5.2021 subjekti i rivlerësimit paraqiti pretendimet me shkrim dhe dokumentacionin justifikues bashkëlidhur pretendimeve në lidhje me rezultatet e hetimit kryesisht me anë të postës elektronike⁵.

11. Më tej, Komisioni njofton subjektin e rivlerësimit me anë të postës elektronike⁶ se trupi Gjykues me vendimin e datës 19.5.2021, vendosi të ftojë për t'u dëgjuar në seancën dëgjimore në datën 26.5.2021, ora 10:00, lidhur me rezultatet e hetimit për vlerësimin e të tria e kritereve: të pasurisë, kontrollit të figurës, si dhe vlerësimin e aftësive profesionale, bazuar në nenin 55, të ligjit 84/2016, "Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", si dhe Kodit të Procedurave Administrative.

12. Bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi të përfundojë procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi), bazuar në të tria kriteret e rivlerësimit: vlerësimi i pasurisë, kontrolli i figurës, si dhe vlerësimi i aftësive profesionale.

²E-mail, datë 2.3.2021, ora 14:31, "Komisioni – Njoftim mbi përfundimin e hetimit kryesisht për procesin tuaj të rivlerësimit".

³E-mail, datë 5.3.2021, ora 11:21.

⁴E-mail, datë 25.3.2021, ora 17:39.

⁵E-mail, datë 17.5.2021, ora 15:25 dhe 18.5.2021, ora 17:41, "Prapësime".

⁶E-mail, datë 19.5.2021, ora 13:21 "Komisioni – Ftesë për seancë dëgjimore publike".

II. SEANCA DËGJIMORE

13. Në datën 26.5.2021 u zhvillua seanca dëgjimore në prezencë të subjektit të rivlerësimit dhe në prani të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger, në përputhje me kërkesat e nenit 55, të ligjit nr. 84/2016. Subjekti i rivlerësimit u paraqiti personalisht në seancë.

14. Relatori i çështjes paraqiti rezultatet e arritura nga Komisioni përgjatë fazës së hetimit administrativ, të kryer mbi të tria kriteret e rivlerësimit dhe të kaluara si barrë prove, apo për shpjegime.

15. Znj. Natasha Prifti (Shallapi), pasi dëgjoi relacionin, shprehu qëndrimin e saj, duke parashtruar shpjegimet përkatëse lidhur me gjetjet e hetimit kryesisht, si dhe mbi procesin e rivlerësimit të kryer për të.

16. Në përfundim të seancës dëgjimore, bazuar në pikën 2, të nenit 4, të ligjit nr. 84/2016, trupi gjykues vendosi ta konsiderojë të plotësuar procesin e rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi), duke u bazuar mbi të tria kriteret e rivlerësimit.

17. Seanca dëgjimore e datës 26.5.2021 u ndërpre, për të rifilluar në datën 28.5.2021, për shpalljen e vendimit.

18. Në përfundim të seancës dëgjimore të datës 28.5.2021, subjekti i rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi), kërkoi konfirmimin në detyrë.

III. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT

19. Subjekti i rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi) ka qenë bashkëpunuese gjatë gjithë procesit, në përputhje me nenin 48, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

IV. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI ADMINISTRATIV I KRYER NGA KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT

20. Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, i cili mbështetet në nenin 179/b dhe në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

21. Sipas kreut IV, V dhe VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”: (i) ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të paraqitur një raport me konstatime në lidhje me vlerësimin pasuror; (ii) DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, duke paraqitur në Komision një raport me konstatimin në lidhje me përshtatshmërinë apo papërshtatshmërinë e subjekti të rivlerësimit; (iii) KLP-ja është organi ndihmës për vlerësimin profesional, i cili në përfundim të shqyrtimit të dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe pesë dokumenteve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, përgatit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar.

22. Referuar vendimit nr. 2/2017⁷, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, Komisioni realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, i cili nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

A. RIVLERËSIMI I PASURISË

A/1 Vlerësimi i pasurisë nga ILDKPKI-ja

23. ILDKPKI-ja, në përputhje me nenin 33, të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar⁸, pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi), që është bërë subjekt deklarues në ILDKPKI në vitin 2007 dhe në zbatim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, “Për deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të detyrimeve financiare të të zgjedhurve dhe të disa nëpunësve publikë”, të ndryshuar, si dhe të ligjit nr. 9367, datë 10.4.2005, “Për parandalimin e konfliktit të interesave në ushtrimin e funksioneve publike”, të ndryshuar.

24. Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar deklaratat e interesave private nga viti 2007 deri në vitin 2016. Nga verifikimi i datës së dorëzimit të deklaratës së pasurisë *Vetting* në zbatim të nenit 31/1⁹, rezulton se subjekti Natasha Prifti (Shallapi) me nr. indeksi ***, e ka dorëzuar deklaratën e pasurisë (duke përfshirë personat e lidhur) në bazë të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 30.1.2017 dhe ky fakt konfirmohet nga ILDKPKI-ja nëpërmjet vërtetimit të lëshuar. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja, për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur, është konstatuar: (a) *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin, ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor*; (b) *ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë*; (c) *nuk ka kryer fshehje të pasurisë*; (ç) *nuk ka kryer deklaram të rremë*; (d) *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesave*.

A/2 Rivlerësimi i pasurisë nga Komisioni

25. Për efekt të procesit të rivlerësimit, personat që janë hetuar si të lidhur, apo të tjerë të lidhur me subjektin e rivlerësimit, janë si vijon:

A.P., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit – konsiderohet person i lidhur.

M. dhe N.P. vajzat e subjektit – konsiderohen persona të lidhur.

E.Z. – konsiderohet person tjetër i lidhur si rezultat i dhënies së huas në shumën 11.000 euro për blerjen e automjetit me targa ***.

⁷Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës, rivlerësimi kryhet nga Komisioni, kurse sipas nenit 4/2, të ligjit nr. 84/2016: “Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit”. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen vetë Komisioni gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1, të ligjit nr. 84/2016, parashikohet se: “Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë”. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII, të ligjit nr. 84/2016, rezulton se: “Në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

⁸Shkresë nr. *** prot., datë 29.5.2018.

⁹Subjekti i rivlerësimit ka detyrimin të plotësojë deklaratën e pasurisë, sipas shtojcës 2 të ligjit, brenda 30 ditëve nga data e hyrjes në fuqi dhe e dërgon atë pranë ILDKPKI-së.

26. Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni hetoi dhe vlerësoi të gjitha faktet dhe rrethanat e nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI në “Deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, *Vetting*”, të vitit 2017; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratat vjetore të deklarimit të pasurisë në ILDKPKI, nga fillimi detyrës deri në vitin 2016; (ç) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (d) deklaramet e subjektit të rivlerësimit me anë të komunikimit elektronik; (dh) shpjegimet me shkrim të subjektit të rivlerësimit, e në vijim, deri ditën e seancës dëgjimore, për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

27. Komisioni hetoi në mënyrë të pavarur çdo informacion dhe konkluzion të ILDKPKI-së, ashtu sikurse të gjitha faktet dhe informacionet e marra nga çdo subjekt i së drejtës, në përputhje me ligjin nr. 84/2016, hetim i cili konsistoi në: (i) verifikimin e vërtetësisë së deklarimeve në lidhje me gjendjen pasurore të subjektit dhe të personave të lidhur; (ii) verifikimin e burimeve të krijimit të të ardhurave dhe të shpenzimeve, me qëllim evidentimin e mungesës së mundshme të burimeve të mjaftueshme financiare për të justifikuar pasuritë; (iii) evidentimin e ndonjë fshehjeje të mundshme të sendeve në pronësi ose në përdorim; dhe (iv) evidentimin e ekzistencës së mundshme të deklarimeve të rreme apo të ndonjë konflikti të interesave, të parashikuar nga pika 5, e nenit 33, e ligjit nr. 84/2016.

*Në lidhje me pasuritë dhe likuiditetet e deklaruara në deklaratën e pasurisë *Vetting* të vitit 2017, nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur:*

1. Llogari rrjedhëse me vlerë 1.316.666 lekë, në “Raiffeisen Bank”

1.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar llogari rrjedhëse në lekë në “Raiffeisen Bank”, me numër ***, sipas vërtetimit përkatës. Vlera: 1.316.666 lekë. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti deklaroi kursimet nga puna dhe bursa që prej vitit 2004. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁰.

1.2. Referuar dokumentacionit të administruar nga “Raiffeisen Bank”¹¹, konfirmohet në emër të subjektit të rivlerësimit llogari “page”, si dhe gjendja e deklaruar prej saj në datën 26.1.2017.

1.3. Komisioni konstatoi se kreditimet në këtë llogari vijnë nga pagat. Më tej, vëren se teprica pozitive e kësaj llogarie ka filluar nga muaji nëntor i vitit 2012 dhe në vijim dhe, për rrjedhojë, bursa e përfutur nga Shkolla e Magjistraturës nuk mund të ketë shërbyer si burim. Subjekti nuk kryen depozitime në këtë llogari, por vetëm tërheqje.

1.4. Në përfundim të hetimit të kësaj llogarie, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari dhe identifikohen qartë transfertat nga paga, pra, verifikohet burimi i ligjshëm i kësaj llogarie.

2. Apartament banimi me qira në vlerën 13.000 lekë/muaj

2.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar apartament me qira, sipas kontratës së qirasë nr. ***, datë 8.9.2009, pranë notere R.K. me palë qiradhënës E.B.,

¹⁰ Vërtetim nr. *** prot., datë 16.1.2017, nga “Raiffeisen Bank”, konfirmon se shtetasja Natasha Prifti në datën 26.1.2017, ka llogari në vlerën 1.316.666 lekë.

¹¹ Shkresë nr. *** prot., datë 18.12.2019.

qiramarrës A.P. Përdorim i përbashkët familjar për banim, me qira 13.000 lekë/muaj. Pjesa takuese: 100% (si familje). Subjekti, për vërtetimin e deklarimeve, ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹².

2.2. Nga hetimi rezultoi se në deklaratimet periodike, ndër vite, subjekti nuk ka deklaruar banimin me qira. Sipas kontratës së paraqitur në deklaratën *Vetting*, vërehet se personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, ka lidhur kontratën e qirasë nr. ***, datë 8.9.2009, me palë qiradhënëse E.B. dhe palë qiramarrëse A.P., me objekt dhënien me qira të apartamentit me sip. 98.1 m², nr. pasurie ***, në lagjen “****” Lushnjë, në vlerën 13.000 lekë/muaj, për një periudhë 4 vjet e tre muaj, duke filluar nga data 8.9.2009 – 31.12.2013. Bashkëlidhur kontratës gjendet vërtetimi hipotekor nr. ***, datë 7.5.2009, i këtij apartamenti, regjistruar në emër të E.B. dhe F.B. Sipas këtij vërtetimi, rezulton se kjo pasuri është përfituar me kontratën e shitjes, nr. ***, datë 22.4.2009.

2.3. Referuar materialit të administruar nga ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë, me anë të postës elektronike në datën 12.11.2019, ora 14:35, konfirmon se pasuria me numër *** e llojit “apartament”, me sip. 98.1 m², është e regjistruar në z. k. ***, vol. ***, f. ***, lagja “****”, Lushnjë, në emër të E.Rr.B. dhe F.K.B., datë 24.4.2009. Origjina e kësaj pasurie është me kontratë shitje në vlerën 3.934.496 lekë. Sipas kartelës së pasurisë bashkëlidhur, rezulton se kjo pronë tashmë e regjistruar në emër të E. dhe F.B. është blerë me vlerë 3.934.496 lekë, regjistruar në datën 24.4.2009. Më parë ka qenë e regjistruar në emër të: (i) shoqërisë “****” sh.p.k. me përfaqësues M.H., regjistruar në datën 23.9.2003; (ii) shtetasit F.S.M., blerë me vlerë 2.365.000 lekë, regjistruar në datën 11.2.2004. Po ashtu, bazuar në shkresën nr. ***, datë 10.12.2020, të ASHK-së Lushnjë, pasuria e mësipërme është e regjistruar në emër të E. dhe F.B., blerë nga shtetasit F. dhe E.M. me kontratën nr. ***, datë 24.4.2009, në vlerë 3.934.496 lekë.

2.4. Komisioni vëren se kontrata e qirasë e lidhur në datën 8.9.2009, rezulton të ketë përfunduar më 31.12.2013 dhe subjekti nuk ka paraqitur rinovimin e kontratës pas përfundimit të afatit të përcaktuar. Për sa rezulton, me anë të pyetësorit nr. 2¹³, subjektit iu kërkua të deklarojë nëse kjo kontratë është rinovuar dhe nëse po, me çfarë kushtesh, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues. Në përgjigje¹⁴ subjekti deklaroi se pas përfundimit të afatit të përcaktuar në kontratën noteriale¹⁵, datë 31.12.2013, kjo kontratë është rinovuar, jo me kontratë noteriale, por verbale. Vlera e qirasë ka vazhduar të jetë 13.000 lekë/muaj. Në cilësinë e provës subjekti paraqiti deklaratën noteriale, nr. ***, datë 11.12.2020, të shtetasit F.B.

2.5. Sipas kësaj deklarate noteriale me objekt “*deklarim për lënie apartamenti në përdorim*”, shtetasja F.B. në cilësinë e bashkëshortes së z. E.B., deklaroi se edhe pas përfundimit të kontratës së qirasë, nr. ***, datë 8.9.2009, kontrata ka vazhduar dhe vazhdon në mënyrë

¹²Vërtetimi i njësisë me origjinalin nr. ***, datë 25.1.2017; kontratë qiraje nr. ***, datë 8.9.2009, me palë qiradhënëse E.B. dhe palë qiramarrëse A.P., vërtetim nga dokumenti hipotekor nr. ***, datë 7.5.2009, të apartamentit me nr. ***, me sip. 98.1 m² e regjistruar në emër të shtetasve E.B. dhe F.B.

¹³E-mail, datë 3.12.2019, ora 10:33.

¹⁴E-mail, datë 16.12.2020, ora 15:58.

¹⁵Shkresë nr. ***, datë 8.9.2009.

verbale, bazuar në marrëdhënien e besimit të krijuar mes palëve. Vlera e qirasë ka vazhduar të jetë 13.000 lekë/muaj për të gjithë periudhën e shfrytëzimit dhe pagesa është bërë *cash* në dorë.

2.6. Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit, nuk ka deklaruar në deklaratimet periodike prej vitit 2012 deri në deklaratën *Vetting*, banimin me qira në apartamentin e ndodhur në lagjen “****”, Lushnjë, megjithatë nga hetimi, lidhur me origjinën e kësaj prone dhe ligjshmërinë e krijimit të saj, nuk rezultuan problematika dhe vërtetohet se subjekti nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, geramat “c”, “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 84/2016.

2.7. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka deklaruar saktë pasuritë në përdorim në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, por duke qenë se nga hetimi i Komisionit nuk u evidentuan problematika në lidhje me krijimin e kësaj pasurie nga qiradhënësit dhe nuk rezultoi deklaram i rremë, fshehje apo mungesë burimesh për subjektin dhe personat e lidhur.

Pasuritë e bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit

Subjekti i rivlerësimit ka lidhur martesë ligjore në datën 29.5.2013, ndërsa në pyetësonin standard deklaroi se ka filluar të bashkëjetojë me bashkëshortin A.P. në janar të vitit 2012. Referuar datës së bashkëjetesës dhe martesës ligjore, Komisioni hetoi pasuritë, shpenzimet dhe detyrimet e bashkëshortit të subjektit si vijon:

3. Pronar me ¼ pjesë në tokën “arë”, me sip. 16.040 m², në S., Lushnjë

3.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, personi i lidhur ka deklaruar: Pronar i ¼ pjesë të pasurisë me nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e llojit “arë”, indeksi i hartës ***, me sip. totale 16.040 m², në emër të kryetarit të familjes bujqësore K.L.L.P., përfituar me ligjin nr. 7501 “Për tokën”. Pjesa takuese: 25%. Për vërtetimin e deklaratimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁶.

3.2. Konstatohet se në DPV-të ndër vite, subjekti dhe personi i lidhur nuk e kanë deklaruar bashkëpronësinë mbi këtë pasuri. Ndërkohë në deklaratën *Vetting*, subjekti ka paraqitur vërtetimin nr. *** prot., datë 23.1.2017, të ZVRPP-së Lushnjë, ku konfirmohet se shtetasi K.P. ka të regjistruar pasurinë nr. ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, lloji “arë”, me sip. 16.040 m². Kjo pasuri është përfituar nga ligji nr. 7501, “Për tokën”. Më tej, me anë të certifikatës së pronësisë nr. ***, vërtetohet se pasuria e llojit “arë” me sip. 16.040 m², në S., Lushnjë, është e regjistruar në emër të shtetasit K.P. (babai i bashkëshortit të subjektit), prej janarit të vitit 1998.

3.3. Sipas materialit të administruar në dosjen e ILDKPKI-së, ASHK Drejtoria Vendore Lushnjë, me anë të postës elektronike, datë 12.11.2019, ora 15:29, konfirmon se pasuria me numër ***, e llojit “arë”, me sip. 16.040 m², është e regjistruar në z. k. ***, vol. ***, f. ***, në S., Lushnjë, përfituar me anë të AMTP-së nr. ***. Kjo pasuri është e regjistruar në emër të përfaqësuesit të familjes bujqësore shtetasit K.L.L.P., për të cilin është lëshuar certifikatë pronësie në datën 6.6.2003. Referuar dokumentacionit të administruar në Komision nga ASHK-ja Lushnjë¹⁷, kjo pronë figuron në emër të shtetasit K.P., regjistruar në datën 20.11.2000.

¹⁶ Vërtetim nr. *** prot., datë 23.1.2017, nga ZVRPP-ja Lushnjë; certifikatë për vërtetim pronësie nr. ***, për pasurinë e llojit “arë” me sip. 16.040 m², e regjistruar në emër të shtetasit K.P., në S., Lushnjë; certifikatë familjare.

¹⁷ Shkresë nr. *** prot., datë 10.12.2020.

3.4. Komisioni vlerëson se bazuar në nenin 4, germa “a”, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, subjekti dhe personat e lidhur mbartin detyrimin të deklarojnë pasuritë e paluajtshme dhe të drejtat reale mbi to, sipas Kodit Civil.

3.5. Komisioni vëren se personi i lidhur nuk e ka deklaruar bashkëpronësinë mbi këtë pasuri gjatë deklaramëve vjetore nga viti 2013 – 2015, megjithatë nga hetimi i Komisioni lidhur me origjinën e kësaj prone, nuk rezultuan problematika dhe vërtetohet se subjekti nuk gjendet në kushtet e parashikuara në nenin 33, pika 5, gerrat “b”, “c”, “ç” dhe “d”, të ligjit nr. 84/2016.

3.6. Në përfundim, Komisioni vlerëson se personi i lidhur me subjektin nuk ka deklaruar saktë bashkëpronësinë mbi këtë pasuri në deklaratat periodike vjetore 2013 – 2015, por duke qenë se nga hetimi i Komisionit nuk u evidentuan problematika në lidhje me krijimin e kësaj pasurie, si nga ana e burimit të krijimit, ashtu edhe mënyra e fitimit të pronësisë, Komisioni nuk e konsideron këtë pasaktësi penalizuese për subjektin e rivlerësimit për atë kohë sa është deklaruar në deklaratën *Vetting* dhe është fituar nga personi i lidhur para se të bashkëjetonte apo të lidhte martesë ligjore me subjektin e rivlerësimit.

4. Llogari rrjedhëse me vlerë 1.505 euro, në “ABI Bank”

4.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, personi i lidhur ka deklaruar llogari bankare në American Bank of Investments, me numër *** dhe ***. Vlera: 1.505,1 euro. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti deklaroi kursime nga të ardhurat e krijuara nga biznesi. Për vërtetimin e deklaramëve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues¹⁸.

4.2. Referuar dokumentacionit të administruar nga “ABI Bank”¹⁹, konfirmohet në emër të shtetasit A.P. llogaria me numër *** në euro, e hapur më 1.4.2015.

4.3. Komisioni konstaton se në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në “ABI Bank”, në datën 1.4.2015 është kryer një depozitim në vlerën 1.500 euro me përshkrim “*derdhje nga A.P. të ardhura nga kursimet*”. Po në këtë datë është krijuar edhe depozita në shumën 1.500 euro. Kjo depozitë është mbyllur në datën 27.6.2018 dhe është transferuar në llogarinë rrjedhëse nga ku është tërhequr më 28.6.2018 nga bashkëshorti i subjektit.

4.4. Në përfundim të hetimit të kësaj llogarie, Komisioni vlerëson se bashkëshorti i subjektit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin këtë llogari dhe ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga aktiviteti i tij tregtar²⁰, pra, verifikohet burimi i ligjshëm i kësaj llogarie.

5. Automjet tip “Daimler Chrysler”, me targa ***

5.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, personi i lidhur ka deklaruar: automjet tip “Daimler Chrysler”, me targa ***, blerë sipas faturës me nr. ***, datë 22.10.2013, me palë shitëse L.B. & Csnc, me vlerë 6.000 euro. Pagesë doganore në vlerën 199.380 lekë. Pjesa takuese: 100%.

¹⁸Vërtetim datë 27.1.2017, nga “ABI Bank”.

¹⁹Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2019.

²⁰Shkresë nr. *** prot., datë 16.12.2020, nga DRT-ja Fier.

Si burim krijimi subjekti deklaron: blerë me të ardhurat nga biznesi ndër vite. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²¹.

5.2. Në DPV-në e vitit 2013 dhe në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar se bashkëshorti i saj ka blerë automjetin me targa *** (targa aktuale ***), tip “C Class”, viti i prodhimit 2007, blerë në Itali, në tetor të vitit 2013, në vlerën 6.000 euro dhe shpenzimet doganore në vlerën 210.000 lekë. Blerë me kursimet nga të ardhurat nga puna. Pagesa është kryer në “Intesa Sanpaolo Bank”, nëpërmjet llogarisë së bashkëshortit.

5.3. Referuar lëvizjes së llogarisë së bashkëshortit të subjektit, në “Intesa Sanpaolo Bank”²², në datën 23.10.2013 është kryer një depozitim në vlerën 6.000 euro me përshkrim “A.P. derdhje për transfertë”. Po në të njëjtën datë është transferuar shuma prej 6.000 euro për llogari të L.B. and C.SNC me përshkrim “prefattura ***, datë 22.10.2013”.

5.4. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja²³, nuk konfirmohet ky automjet në pronësi të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe për verifikim është ridërguar shkresa nr. *** prot., datë 25.11.2020. Në përgjigjen²⁴ e DRSHTRR-së rezulton se ky mjet është i regjistruar në pronësi të shtetasit A.K.P., ndërkohë nga kontrolli i kryer në AMF, referuar policave të sigurimit automjeti rezulton në pronësi të shtetasit A.P., prej vitit 2013.

5.5. Në dokumentacionin e dërguar në deklaratën *Vetting*, subjekti ka bashkëlidhur shkresën nr. *** prot., datë 6.1.2017, të DPSHTRR-së, e cila konfirmon se shtetasi A.P. ka të regjistruar automjetin me targa ***, tip “Daimler Chrysler”, viti i prodhimit 2007. Sipas faturës së datës 22.10.2013 dhe deklaratës doganore nr. ***, datë 10.11.2013, ky automjet është blerë në vlerën 6.000 euro dhe shpenzimet doganore janë në shumën 199.380 lekë, pra, në total 1.040.040 lekë²⁵. Gjithashtu, në dosjen e ILDKPKI-së, me shkresën nr. *** prot., datë 1.8.2017, të administruar nga DRSHTRR-ja, konfirmohet se shtetasi A.P., ka në pronësi automjetin e mësipërm.

5.6. Referuar analizës financiare dhe arsyetimit në pikën 7, personi i lidhur/bashkëshorti ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e këtij automjeti.

6. Automjet furgon tip “Mercedes-Benz”, me targa *, në vlerën 8.400 euro**

6.1. Në deklaratën *Vetting* të vitit 2017, personi i lidhur ka deklaruar: Automjet furgon tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, blerë sipas kontratës së shitjes së datës 8.10.2015 me një vlerë prej 8.400 euro. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi deklaron të ardhurat nga biznesi ndër vite. Për vërtetimin e deklarimeve, subjekti ka paraqitur dokumentacion ligjor provues²⁶.

²¹Shkresë nr. *** prot., datë 6.1.2017, nga DPSHTRR-ja, e cila konfirmon se shtetasi A.P. ka të regjistruar automjetin me targa ***, tip “Daimler Chrysler”; faturë në gjuhën italiane, datë 22.10.2013, për automjetin tip “Daimler Chrysler”, në vlerën 6.000 euro; urdhër çlirim; deklaratë doganore, datë 10.11.2013, në vlerën 199.380 lekë.

²²Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2019.

²³Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2019.

²⁴Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2020.

²⁵Çmimi 6.000 euro vlerësuar me kursin e këmbimit të pasqyruar në deklaratën doganore, 1 euro = 140.11 lekë. U përfshinë edhe shpenzimet doganore.

²⁶Shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 6.1.2017, nga DPSHTRR-ja, e cila konfirmon se shtetasi A.P. ka të regjistruar mjetin, me targa ***, tip “Mercedes-Benz”; faturë nr. ***, datë 8.10.2015, me palë shitëse personin fizik “B.K.” dhe palë blerëse A.P., të automjetit furgon tip “Mercedes-Benz”, në vlerën 8.400 euro, kontratë shitjeje datë 8.10.2015.

6.2. Në DPV-në e vitit 2015, personi i lidhur ka deklaruar se ka blerë automjetin furgon tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, në vlerën 8.500 euro, nga kursimet personale. Gjithashtu, është deklaruar pakësim i gjendjes së të ardhurave *cash* (blerje automjeti dhe shpenzime të ndryshme familjare) në vlerën 1.900.000 lekë. Ndërkohë, në pyetësonin standard këtë automjet e deklaroi në vlerën prej 8.400 euro.

6.3. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja²⁷, konfirmohet se automjeti tip “Mercedes-Benz”, viti i prodhimit 2008, me targa *** (***) është i regjistruar në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Ky automjet është blerë me faturën tatimore të shitjes me nr. ***, datë 8.10.2015, me palë shitëse person fizik “B.K.” dhe palë blerëse shtetasin A.P., në vlerën 8.400 euro (8.400 euro x 139.73 = 1.173.732 lekë), si dhe kontratë shitje (jo para noterit) e datës 8.10.2015. Sipas deklaratës doganore, datë 18.9.2015, ky automjet është blerë nga person fizik “B.K.”, në vlerën 6.500 euro dhe shpenzime doganore në shumën 188.774 lekë.

Më tej, ky automjet i është shitur shtetasit E.Ç. me kontratën nr. ***, datë 30.11.2017, në vlerën 1.500.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale, deklaruar edhe në DPV-në e vitit 2017²⁸. Në seksionin e të ardhurave të kësaj deklarate vjetore, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar shumën prej 337.000 lekësh si të ardhura të përfituara nga shitblerja e këtij automjeti.

6.4. Referuar llogarisë së bashkëshortit të subjektit në “ABI Bank”²⁹, në datën 30.11.2017 është depozituar shuma prej 1.500.000 lekësh me përshkrim “cash deposit E.C. derdhje për A.P. për blerje automjeti”. Gjithashtu, nga kontrolli i kryer në AMF, referuar policave të sigurimit, ky automjet rezulton në pronësi të shtetasit A.P., deri në fund të vitit 2017 dhe, më pas, ka kaluar në pronësi të shtetasit E.Ç.

6.5. Komisioni vëren se automjeti është shitur pas 2 vjetësh, me një diferencë prej 326.268 lekësh më shumë nga çmimi i blerjes.

6.6. Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë³⁰, nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti (diferenca prej 326.268 lekësh mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes) dhe për këtë arsye vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar. Për këtë arsye, në analizën financiare të vitit 2017, u pasqyruan të ardhura nga shitja, të barabarta me koston e blerjes, në shumën prej 1.173.732 lekësh.

6.7. Lidhur me ligjshmërinë e burimeve financiare, duke qenë se subjekti ka deklaruar pakësim të gjendjes *cash*, Komisioni kreu analizën financiare për pasuritë, të ardhurat dhe shpenzimet e subjektit dhe personit të lidhur në datën 31.12.2015 dhe rezultoi se kanë pasur burime të ligjshme financiare për kryerjen e shpenzimeve dhe blerjen e pasurive në vitin 2015.

6.8. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën

²⁷Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2019.

²⁸Subjekti ka deklaruar shitjen e këtij automjeti me kontratën nr. ***, datë 30.11.2017, në vlerën 1.500.000 lekë.

²⁹Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2019.

³⁰Shkresë nr. *** prot., datë 13.1.2020.

e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti për shumën e përfutur prej 326.268 lekë.*

Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se fitimi që mund të realizohet nga shitja e automjeteve nuk është e ardhur e tatueshme. Ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat “ i ndryshuar, vijon subjekti, nuk parashikon pagesë të tatimit mbi të ardhurat për individët për shitjen e automjeteve në asnjë nen apo paragraf të tij. Gjithashtu, edhe në Udhëzimin nr. 5, datë 18.1.2005, të Ministrisë së Financave, i cili e analizon më në detaje këtë procedurë nuk parashikohet një taksim i tillë.

Në nenin 155 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë përcaktohet se: *“Taksat, tatimet dhe detyrimet financiare kombëtare e vendore, lehtësimi ose përjashtimi prej tyre i kategorive të caktuara të pagesve, si dhe mënyra e mbledhjes së tyre caktohen me ligj”*. Pra, Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë përcakton mjaft qartë se taksat dhe tatimet vendosen vetëm me ligj dhe asnjë organ shtetëror apo publik nuk mund të përcaktojë se cilat janë të ardhurat e tatueshme. Në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat” nuk parashikohet se fitimi i realizuar nga individët, nga shitja e automjeteve është një e ardhur e tatueshme, në këtë kuadër Komisioni nuk mund ta kategorizojë këtë të ardhur si të ardhur të tatueshme. Të njëjtin qëndrim ka mbajtur edhe Kolegji në vendimin nr. 12/2018 ndaj subjektit të rivlerësimit B. D., në të cilin arsyeton se: *“... Kushtetuta nuk e ka lënë në diskrecionin e organeve ligjzbatuese përcaktimin e të ardhurave “të tatueshme”, por ia ka njohur vetëm ligjit. Për këtë arsye, pjesa e shkëputur e fjalisë “të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e parashikuara në këtë nen” mund të gjejë zbatim vetëm brenda një norme pozitive ligjore, jo akti nënligjor dhe as diskrecional të organeve publike ...”*.

6.9. Më tej, subjekti deklaroi se Komisioni në analizën e kryer ka marrë si përfitim *neto* diferencën e çmimit të shitjes me çmimin e blerjes, ndërkohë që bashkëshorti pasi e ka blerë automjetin ka kryer edhe disa shpenzime të tjera për ta riparuar atë. Ky automjet është përdorur për qëllime të aktivitetit tregtar dhe shpenzimet e kryera për rregullimin shpesh herë përzihen me shpenzimet e personit fizik. Në përfundim, subjekti shton se fitimi i realizuar nga shitja e automjeteve nuk ka shërbyer për krijimin apo blerjen e ndonjë pasurie.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

6.10. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratën e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

6.11. Në lidhje me pretendimin e subjektit për të konsideruar në analizën financiare të ardhurat nga shitja e automjetit, pasi nuk mund të kategorizohet si e ardhur e tatueshme, Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka realizuar fitim nga shitja e këtij automjeti dhe në vlerësim të

parashikimeve të germës “g”, të pikës 1, të nenit 8, të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, i cili përcakton se: *“Për qëllime të tatimit mbi të ardhurat personale merren si të ardhura të tatueshme të ardhura të tjera që nuk identifikohen në format e paraqitura në këtë nen, të realizuara nga individë rezidentë, ose nga persona jorezidentë, por me burim në Republikën e Shqipërisë”*.

6.12. Nën dritën e sa më sipër, të ardhurat e realizuara nga shitja me fitim e pasurive të luajtshme nuk bëjnë pjesë në të ardhurat e përjashtuara nga neni 8/1 i të njëjtit ligj. Për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e automjeteve (diferenca mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes së automjetit), nuk u provua pagimi i detyrimit tatimor mbi këtë fitim. Për rrjedhojë, vlera e fitimit të realizuar rezulton të jetë e ardhur e paligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

6.13. Vendimi i Kolegjit të Posaçëm të Apelit tek i cili referohet subjekti në mbështetje të pretendimit të tij, ka të bëjë me një rrethanë të ndryshme nga ajo e rastit konkret. Tashmë në jurisprudencën e Kolegjit³¹ është konsoliduar qëndrimi për të ardhurat e realizuara nga shitja e automjeteve, duke e konsideruar fitimin e realizuar nga shitja e automjeteve, për të cilin nuk provohet pagimi i detyrimit tatimor, si të ardhur të paligjshme, në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016.

6.14. Në përfundim, Komisioni vlerëson se shuma prej 326.268 lekësh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes nuk duhet të konsiderohet si e ardhur në analizën financiare.

7. Lidhur me analizimin e pasurive të luajtshme dhe likuiditeteve të deklaruara nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit në deklaratën periodike të vitit 2013

7.1. Rezulton se subjekti ka lidhur martesë ligjore në datën 29.5.2013 dhe në pyetësozin standard deklaroi se ka filluar të bashkëjetojë me bashkëshortin A.P. në janar të vitit 2012. Në deklaratën e vitit 2013, vit në të cilin personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit deklaroi për herë të parë, ka deklaruar likuiditete *cash* në vlerën 4.000.000 lekë me burim të ardhurat nga puna, ndër vite, prej vitit 1998.

7.2. Për rrjedhojë, duke qenë se: (i) nuk disponohet informacion lidhur me vlerën e saktë të likuiditeteve *cash* të bashkëshortit gjatë bashkëjetesës me subjektin; (ii) dy nga automjetet e deklaruara në DPV-në e vitit 2013 janë blerë gjatë bashkëjetesës dhe pas lidhjes në martesë³², Komisioni vlerësoi të kryejë analizën financiare për burimet e ligjshme për pasuritë e deklaruara në DPV-në e vitit 2013, duke përfshirë: (a) të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e bashkëshortit për periudhën 2001 – 2013; si dhe (b) të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë e subjektit për periudhën 2012 – 2013.

7.3. Pasuritë e luajtshme dhe likuiditetet e deklaruara nga personi i lidhur në DPV-në e vitit 2013 janë: (i) automjet tip “AUDI A4”, me targa ***; (ii) automjet furgon tip “Mercedes-Sprinter”, me targa ***; (iii) automjet furgon tip “Mercedes-Benz”, me targa *** (trajtuar në pikën 6); (iv) gjendje malli, inventari në magazinë, objekt i ushtrimit të aktivitetit privat në

³¹Vendim nr. 11-2019 (JR), datë 22.5.2019; vendim nr. 34-2019 (JR), datë 2.12.2019.

³²Konkretisht automjetet janë blerë në datat 14.10.2013 dhe 10.11.2013.

vlerën 10.000.000 lekë; (v) gjendje të ardhurash *cash*, të krijuara nga puna, ndër vite, prej vitit 1998, në shumën 4.000.000 lekë.

- *Lidhur me automjetin tip "AUDI A4", me targa ****

7.4. Në DPV-në e vitit 2013, personi i lidhur ka deklaruar automjet tip "AUDI A4", me targa ***, viti i prodhimit 2002, blerë në vitin 2010 në Itali, në vlerën 5.700 euro dhe shpenzimet doganore në shumën 370.00 lekë. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi deklaroi kursimet nga të ardhurat e përfituara nga puna.

7.5. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja³³, rezultoi se bashkëshorti i subjektit ka pasur të regjistruar automjetin me targa ***, për periudhën 28.2.2011 – 12.2.2016. Sipas deklaratës doganore nr. ***, datë 25.2.2011, ky automjet ka kushtuar 4.000 euro dhe shpenzimet doganore janë në shumën 369.407 lekë, pra, në total në shumën 926.647 lekë³⁴.

7.6. Nga hetimi i Komisionit, rezultoi se pranë zyrës së noteres publike E.S.³⁵, është lidhur kontrata e shitjes së këtij automjeti, nr. ***, datë 2.12.2015, me palë shitëse bashkëshorti i subjektit, kundrejt çmimit 2.500 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

7.7. Në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 23.2.2016, e pyetur lidhur me këtë automjet, subjekti ka paraqitur faturën e blerjes në shumën 4.000 euro. Në DPV-në e vitit 2015, personi i lidhur deklaroi se ky automjet është shitur në shumën 2.500 euro. Nga kontrolli i kryer në AMF, referuar policave të sigurimit, automjeti rezultoi në pronësi të shtetasit A.P. prej vitit 2011 deri në vitin 2015.

7.8. Me anë të pyetësorit nr. 2³⁶, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për blerjen e këtij automjeti dhe në përgjigje³⁷ paraqiti faturën, nr. ***, datë 9.12.2010, të lëshuar nga "****", me vlerë 4.000 euro. Më tej, sqaroi se vlera e këtij automjeti është 4.000 euro referuar çmimit në kontratë dhe deklarimi i bashkëshortit të subjektit në DPV-në e vitit 2013 është lapsus.

7.9. Sa më sipër, në analizën financiare u konsiderua si kosto blerje shuma 926.647 lekë (analiza financiare për periudhën 2001 – 2013) dhe si të ardhura nga shitja shuma 349.325 lekë³⁸ (analiza financiare për vitin 2015).

- *Lidhur me automjetin furgon tip "Mercedes-Sprinter", me targa ****

7.10. Në DPV-në e vitit 2013, personi i lidhur, ka deklaruar automjet tip "Mercedes-Sprinter" me targa ***, vit prodhimi 2006, blerë në Itali, në gusht të 2013, në vlerën 1.000 euro dhe shpenzimet doganore në shumën 1.100 euro. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi deklaroi kursimet nga të ardhurat e përfituara nga puna.

³³Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2019.

³⁴Çmimi 4.000 euro vlerësuar me kursin e këmbimit të pasqyruar në deklaratën doganore, 1 euro = 139.31 lekë. U përfshinë edhe shpenzimet doganore.

³⁵Shkresë protokolluar në Komision me nr. ***, datë 24.6.2020.

³⁶E-mail, datë 3.12.2019, ora 10:33.

³⁷E-mail, datë 16.12.2020, ora 15:58.

³⁸Çmimi 2.500 euro vlerësuar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 2.12.2015, 1 euro = 139.73 lekë.

7.11. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja³⁹, rezulton se bashkëshorti i subjektit ka pasur të regjistruar automjetin me targa ***, për periudhën 17.10.2013 – 12.5.2014. Referuar deklaratës doganore nr. ***, datë 14.10.2013, ky automjet ka kushtuar 900 euro dhe shpenzimet doganore janë në shumën 103.469 lekë, pra, në total 230.702 lekë⁴⁰. Referuar vlerës statistikore pasqyruar në kutinë nr. *** të deklaratës doganore nr. ***, datë 14.10.2013, çmimi i referencës përlllogaritet në shumën 517.353 lekë. Sipas dokumentacionit bashkëlidhur me anë të kontratës nr. ***, datë 7.5.2014, ky automjet është shitur në vlerën 9.300 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale, pra, në total 1.302.837 lekë⁴¹.

7.12. Në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 29.1.2016, subjekti shpjegon se shitja e këtij automjeti nuk është deklaruar për arsye harrese, nuk ka pasur qëllim fshehjen, duke qenë se ka deklaruar blerjen e tij. Nga kontrolli i kryer në AMF, referuar policave të sigurimit, automjeti rezulton në pronësi të shtetasit A.P. prej vitit 2013 – 2014. Me anë të pyetësorit nr. 2⁴², subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për blerjen e tij. Në përgjigje⁴³ subjekti paraqiti faturën nr. ***, datë 28.8.2013 të lëshuar nga “***”, me vlerë 900 euro, timbruar/vulosur nga Dogana Durrës në datën 14.10.2013. Më tej, sqaroi se vlera e këtij automjeti është 900 euro referuar çmimit në kontratë dhe deklarimi i bashkëshortit të subjektit në DPV-në e vitit 2013 është lapsus. Komisioni vëren se automjeti është shitur pas 6 muajsh, me një diferencë prej 1.072.135 lekësh më shumë nga çmimi i blerjes, çka duket jashtë logjikës së tregut.

7.13. Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁴⁴ nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti (diferenca prej 1.072.135 lekësh mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes) dhe, për këtë arsye, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar. Për këtë arsye, në analizën financiare të vitit 2014 u pasqyruan të ardhura nga shitja të barabarta me koston e blerjes, pra, në shumën 230.702 lekë.

7.14. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *Ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti për shumën 1.072.135 lekë.*

7.15. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, paraqiti shpjegime të njëjta si në rastin e të ardhurave të përfituara nga shitja e automjetit me targa ***, në paragrafët e mësipërm.

³⁹Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2019.

⁴⁰Çmimi 900 euro vlerësuar me kursin e këmbimit të pasqyruar në deklaratën doganore, 1 euro = 141.37 lekë. U përfshinë edhe shpenzimet doganore.

⁴¹Çmimi 9.300 euro vlerësuar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë, datë 7.5.2014, 1 euro = 140.09 lekë.

⁴²E-mail, datë 3.12.2019, ora 10:33.

⁴³E-mail, datë 16.12.2020, ora 15:58.

⁴⁴Shkresë nr. *** prot., datë 13.1.2020.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.16. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore i qëndron arsyetimit në paragrafët 6.11 - 6.14.

7.17. Në përfundim, Komisioni vlerëson se shuma prej 1.072.135 lekësh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes nuk duhet të konsiderohet si e ardhur në analizën financiare.

- *Lidhur me automjetin furgon tip “Mercedes-Benz”, me targa *** (trajtuar në pikën 6), si dhe gjendje malli, inventari në magazinë, objekt i ushtrimit të aktivitetit privat në vlerën 10.000.000 lekë*

7.18. Subjekti, i pyetur lidhur me këtë deklaram, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 29.1.2016, shpjegon se aktiviteti është person fizik në emër të bashkëshortit, me objekt shitje mallrash me shumicë dhe pakicë. Deri në vitin 2015, vijon subjekti, nuk është kërkuar për personin fizik inventarizim të mallit, si rrjedhim, bashkëshorti ka pasur vetëm libër blerje-shitje. Më tej, në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 23.2.2016, subjekti ka deklaruar se gjendja e mallit i përket veprimtarisë së biznesit të bashkëshortit dhe nuk ka detyrim për deklaram.

7.19. Sa më sipër, shuma totale e pasurive të luajtshme dhe likuidimeve të personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit në datën 31.12.2013 (përfshirë gjendjen e likuiditeteve në bankë) ka qenë në shumën 6.197.669 lekë. Në vijim, Komisioni analizoi të ardhurat që kanë shërbyer për krijimin e këtyre pasurive.

7.20. Në deklaratën *Vetting* personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka deklaruar të ardhura nga aktiviteti “A.P.”, me objekt “tregti artikuj të ndryshëm industriale” (fillimisht edhe objekt “shërbim informacion për shitblerje pasuri të paluajtshme) me NIPT ***. Sipas të dhënave të DRT-së Fier dhe Bashkisë Lushnjë, për periudhën 2003 – 2015 qarkullimi total ka qenë në vlerën 36.215.888 lekë. Bashkëshorti i subjektit deklaroi se fitimi *neto* për këtë qarkullim total ka në vlerën prej 9.485.000 lekësh. Gjithashtu, deklaroi të ardhura nga aktiviteti “A.P.”, me NIPT ***, për vitin 2016 në vlerën 467.963 lekë.

7.21. Personi i lidhur deklaroi se nga DRT-ja Fier ka ardhur informacioni se për subjektin “A.P.” nuk ka të dhëna për periudhën 2001 – 2002, ndërkaq, që si subjekt në DRT Fier është regjistruar që në vitin 2001 me kod fiskal ***. Këtë e provon me: vendimin nr. ***, datë 13.2.2001 dhe nr. ***, datë 12.1.2001, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me objekt regjistrimin si person fizik “A.P.”; pagesat pranë Sigurimeve Shoqërore si person fizik për aktivitetin që prej vitit 2001; certifikatë regjistrimi si biznes i vogël në organin tatimor me kod fiskal ***, në të cilin përmendet se regjistrimi në organin tatimor është bërë në datën 13.02.2001; qarkullimi total i deklaruar prej tij për këtë periudhë ka qenë i përafërt me vitet në

vijim, 2003, 2004 dhe 2005. Vlerë nuk ka. Në deklaratën *Vetting* subjekti ka dorëzuar dokumentacion ligjor justifikues⁴⁵.

7.22. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se lidhur me të ardhurat nga aktiviteti tregtar për periudhën 2001 – 2013, Drejtoria Rajonale Tatimore Fier⁴⁶ ka përcjellë informacion për periudhën 2001 – 2006, konkretisht totali i qarkullimit për këtë periudhë ka qenë në vlerën 23.725.146 lekë dhe tatim fitimi i paguar në vlerën 586.460 lekë. Lidhur me tatimin e paguar për vitet 2001 dhe 2012, DRT-ja Fier nuk ka përcaktuar vlera, por ka përcjellë tri fletë njoftim tatimi, ku tatimi figuron në shumën totale prej 168.236 lekësh. Më tej, shkresës i është bashkëlidhur dokumentacion⁴⁷, i cili vërteton sa cituar nga DRT-ja Fier.

7.23. Bashkia Lushnjë⁴⁸ informon lidhur me shitjet dhe blerjet e realizuara nga ky subjekt tregtar për periudhën 2007 – 2013, me përjashtim të vitit 2011, për të cilin disponohet vetëm xhiro e parashikuar. Konkretisht për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2012 dhe 2013 shitjet e realizuara kanë qenë në shumën 10.997.950 lekë dhe blerjet në shumën 8.995.830 lekë, ndërsa qarkullimi i parashikuar për vitin 2011 ka qenë në shumën prej 1.750.000 lekësh. Më tej, shkresës i është bashkëlidhur dokumentacion⁴⁹, i cili vërteton sa cituar nga ana e Bashkisë Lushnjë. Referuar shkresës nr. ***, datë 25.1.2017, lëshuar nga Bashkia Lushnjë dorëzuar nga subjekti në deklaratën *Vetting*, taksa vendore mbi biznesin e vogël për periudhën 2007 – 2013 ka qenë në shumën totale prej 295.200 lekësh.

7.24. Sa më sipër, konstatohet se mungon informacioni lidhur me fitimin për vitet 2001 – 2006, si dhe për vitin 2011. Me qëllim përcaktimin e fitimit për këtë periudhë, Komisioni iu referua marzhit të fitimit për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2012 dhe 2013, nga ku rezultoi një normë prej 18,31%.

7.25. Në përfundim të sa më lart, për periudhën 2001 – 2013 fitimi *neto* u përllogarit në vlerën totale prej 5.655.602 lekësh. Më tej, Komisioni e përfshiu këtë shumë në analizën financiare për periudhën 2001 – 2013, duke analizuar të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e personit të

⁴⁵Vendim nr. ***, datë 12.1.200, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e A.P. si person fizik privat në fushën e tregtimit të artikujve të ndryshëm industrial; vendim nr. ***, datë 13.2.2001, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë, për regjistrimin e A.P., si person fizik privat në fushën e tregtimit të artikujve të ndryshëm industriale dhe shitblerje të pasurive të paluajtshme; certifikatë për regjistrimin në organin tatimor në emër të A.P., me kod fiskal ***, ku specifikohet se është regjistruar me vendim gjykate nr. ***, datë 13.2.2001 dhe në organin tatimor në datën 13.2.2001, me aktivitet “shërbim informacion për shit-blerjen e pasurive të paluajtshme”; certifikatë për regjistrimin në organin tatimor në emër të A.P., me NIPT ***, ku specifikohet se është regjistruar me vendim gjykate nr. ***, datë 13.2.2001; vërtetim nr. ***, datë 28.1.2017, nga ISSH, vërtetohet se A.P. është i siguar pranë subjektit ALSSH Lushnjë me NIPT ***, për periudhën 1.1.2000 – 31.12.2000; vërtetim nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga ISSH, vërtetohet se A.P. është i siguar, pranë subjektit ALSSH Lushnjë- person fizik me NIPT ***, për periudhën 12.1.2001 – 31.12.2016; shkresë kthim përgjigje nr. *** prot., datë 21.12.2016 dhe nr. *** prot., datë 24.1.2017, nga DRT-ja Fier, ku konfirmohet se A.P. figuron i regjistruar me NIPT ***, me aktivitet “tregti artikuj të ndryshëm industrialë” nga data 29.5.2003.

⁴⁶Shkresë nr. *** prot., datë 16.12.2020.

⁴⁷Librat e shitjeve dhe blerjeve për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2012 dhe 2013.

⁴⁸Shkresë nr. *** prot., datë 11.2.2020.

⁴⁹Vendim gjykate nr. ***, datë 13.2.2001, për regjistrimin e personit fizik; deklaratë mbi të ardhurat e realizuara për periudhën 1.1.2001-31.12.2001; fletë njoftim tatimi në datat 26.12.2002 dhe 28.2.2002; tre formularë me emërtim “Tabela e Llogaritjes për Taksën vendore mbi Biznesin e Vogël dhe Tatimit të Thjeshtuar”; deklaratë datë 3.3.2005 mbi të ardhurat e realizuara për periudhën 1.1.2004 – 31.12.2004; formularët e deklarimit dhe pagesës së tatimit të thjeshtuar mbi fitimin për vitet 2005 dhe 2006.

lidhur/bashkëshortit për këtë periudhë dhe të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2012 – 2013 (periudha e bashkëjetesës), nga ku rezultoi një mungesë e burimeve financiare të ligjshme në vlerën 3.460.498 lekë.

7.26. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me këtë konstatim.

7.27. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se i ka kërkuar një audituesi ligjor të pavarur të përlllogarisë me metoda alternative fitimin e realizua, si dhe të kryejë një përlllogaritje të mundshme të të ardhurave shpenzimeve dhe pagesave të kredive dhe interesave të tyre për këtë periudhë.

7.28. Referuar këtij raporti, fitimi mesatar i realizuar është në masën 25,54% ose 9.314.113 lekë për të gjithë periudhën 2001 – 2013, e thënë ndryshe, citohet në raport, subjekti ka realizuar mesatarisht 59.706 lekë/muaj ose 1.963 lekë/ditë.

7.29. Audituesi ligjor ka analizuar legjislacionin tatimor, i cili ka ndryshuar vazhdimisht gjatë kësaj periudhe, si dhe reformat e ndërmarra, ndër vite, dhe ka arritur në konkluzionin se marzhi mesatar i fitimit duhet të përlllogaritet për marzhin e njohur nga viti 2009 dhe në vazhdim për shkak të ndryshimeve dhe përmirësimit të sistemit tatimor në këto vite.

7.30. Sipas konkluzionit të arritur në aktin e ekspertimit, vijon subjekti, të dhënat e deklaruara nga bizneset për vitin 2009 (të dhëna të deklaruara në vitin 2010) dhe në vazhdim për shkak të ndryshimeve në përmirësimin e sistemit tatimor dhe detyrimit që ka tatimpaguesi për të deklaruar pranë administratës tatimore, janë të dhëna më të besueshme për t'u përdorur si të dhëna bazë për përlllogaritjen e fitimit për vitet kur ky informacion mungon.

7.31. Më tej, subjekti deklaroi se bashkëshorti e ka informuar se gjatë viteve të para të ushtrimit të aktivitetit, marzhi i fitimit ka qenë tejet i lartë pasi ka pasur numër të kufizuar operatorësh në treg, vetë tregu kishte kërkesë të madhe për blerje dhe ka qenë pothuajse bosh, duke u ndihmuar dhe nga pozicioni i favorshëm i vendit ku ushtrohej aktiviteti. Në vitet e fundit marzhi i fitimit ka rënë për shkak të ngopjes së tregut me produkte dhe shtimit tejet të lartë të operatorëve tregtarë. Nuk ka arritur të gjejë të dhëna të sakta për marzhet e fitimit, por nga sa e informon bashkëshorti, ato kanë qenë mbi 30% në vitet e para dhe sqaron që norma e marzhit 18.31% është dukshëm i ulët dhe i ndikuar nga raportet e marzhit për vitin 2007 dhe 2008 të cilat nuk paraqesin marzhin e tregut dhe arsyeja është se një pjesë e blerjeve ka qenë për investim⁵⁰.

⁵⁰Subjekti shpjegoi se: “Këtë e përforcon edhe fakti që në vitin 2008 marzhi është -0.4%, që do të thotë se bashkëshorti i subjektit ka shitur më lirë se sa ka blerë, veprim ky pa logjikë ekonomike dhe që nuk mund të ketë ndodhur realisht. Marzhi i fitimit në vitet e para të ushtrimit të aktivitetit ka qenë më i lartë se 25.54%, që rezultoi në vitet 2009 deri në vitin 2013. Në periudhën 2001–2005 edhe norma e interesit bankar ka qenë e lartë, referuar edhe dokumentacionit të gjeneruar nga Banka e Shqipërisë⁵⁰ interesi i depozitave ka variuar në 7-8% deri në vitin 2004 dhe 5.5% në vitin 2005. Ndryshe nga vitet më vonë ku norma e interesit ka vazhduar të jetë në rënie. Nëse përfitimi nga lënia e shumës së të hollave ka qenë 7% ky është një fakt i pakundërshtueshëm që norma e fitimit për biznesin ka qenë disa herë më e lartë”.

7.32. Në përfundim, duke konsideruar të ardhura nga aktiviteti tregtar i bashkëshortit të subjektit në shumën 9.314.113 lekë për periudhën 2001 – 2013, balanca pozitive e pasqyruar në raportin e audituesit ligjor rezulton në 198.014 lekë dhe, për rrjedhojë, deklaroi subjekti, bashkëshorti ka pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e pasurive të luajtshme dhe kursimeve të krijuar deri në datën 31.12.2013

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

7.33. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

7.34. Qarkullimi i realizuar për 6 vitet e para të zhvillimit të aktivitetit, periudha 2001 – 2006, ka qenë në shumën 23.725.146 lekë përkundrajt shumës totale prej 12.747.950 lekësh, për periudhën 2007 – 2013, rreth 1.8 herë më i lartë, çka përkthehet në një fitim më të lartë *neto* për biznesin në kushtet kur disa prej shpenzimeve janë fikse dhe të pandikuara ndjeshëm nga niveli i qarkullimit.

7.35. Kjo mbështetet edhe nga analizimi i të dhënave statistikore lidhur me ritmet e zhvillimit të ekonomisë në Shqipëri përgjatë viteve të shqyrtuara në këtë analizë, konkretisht: [...] *rritja ekonomike mesatare e Shqipërisë përgjatë viteve 2002-2012 është me një rritje mesatare në nivelin 4.5%. Në gjysmën e parë të periudhës ka pasur një tendencë mesatare rritje 5.8%. Në gjysmën e dytë të periudhës, rritja është ngadalësuar (veçanërisht pas vitit 2008) me një tendencë rritje mesatare 3.2%⁵¹ [...].*

7.36. Për sa më lart, pretendimi i subjektit për aplikimin e një marzhi më të lartë në vitet e para të zhvillimit të aktivitetit gjendet i bazuar dhe, për pasojë, Komisioni vlerësoi të aplikojë një marzh fitimi në masën 25,54%⁵², për vitet 2001 – 2006, vite për të cilat nuk ka informacion nga organet kompetente lidhur me fitimin e realizuar dhe një marzh i tillë është i pranueshëm për llojin e aktivitetit që ushtron bashkëshorti (tregti e mallrave industriale). Nga përllogaritjet rezultoi një fitim në shumën 6.058.414 lekë.

7.37. Ndërkohë që, pavarësisht se në raportin e audituesit ligjor është aplikuar norma e fitimit 25,54% edhe në vitet për të cilët ka të dhëna, Komisioni vlerësoi që fitimi për këto vite të mbetet i pandryshuar në shumën totale prej 2.042.120 lekësh, për sa kohë që Bashkia Lushnjë⁵³, për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2012 dhe 2013, ka përcjellë informacion të mjaftueshëm për përcaktimin e fitimit. Ndërsa për vitin 2011, Komisioni vlerësoi të aplikojë një normë fitimi prej 23,82%, si mesatare e normës së fitimit të vitit paraardhës dhe vitit pasardhës dhe përllogariti një fitim në shumën 416.815 lekë.

⁵¹<https://www.monitor.al/rritja-ekonomike-ne-shqiperi-faktoret-ndikues-dje-sot-dhe-neser/>

⁵²Kjo normë është përllogaritur si mesatare e normave të fitimit të realizuar për vitet 2009, 2010, 2012 dhe 2013

⁵³Me shkresën nr. *** prot., datë 11.12.2020, Bashkia Lushnjë ka përcjellë libra blerje dhe shitje për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2012 dhe 2013.

7.38. Sa më lart, fitimi i aktivitetit të bashkëshortit (përpara pagesës së tatimit) u përlogarit në shumën totale prej 8.517.350 lekësh⁵⁴.

7.39. Më tej, në fitimin e pretenduar nga subjekti, nuk janë konsideruar detyrimet tatimore të paguara, ndër vite, në shumën totale 1.049.896 lekë⁵⁵, për periudhën 2001 – 2013, ndërkohë që Komisioni e konsideroi në përlogaritjet e kryera dhe në përfundim, rezultoi një fitim *neto* në shumën 7.467.454 lekë.

7.40. Në përfundim, pas përfshirjes së fitimit të rillogaritur, rezultoi një mungesë e burimeve financiare të ligjshme në vlerën 1.648.646 lekë duke konsideruar të ardhurat, pasuritë dhe shpenzimet e personit të lidhur/bashkëshortit për periudhën 2001 – 2013 dhe të subjektit të rivlerësimit për periudhën 2012 – 2013 (periudha e bashkëjetesës).

7.41. Në analizë të sa më sipër, Komisioni vlerëson të marrë në konsideratë faktin se mungesa e burimeve financiare të ligjshme në vlerën 1.648.646 lekë përfshin: (i) analizimin e një periudhë relativisht të gjatë të jetës së bashkëshortit përpara lidhjes së martesës ligjore, rreth 12 vjet, nga të cilat 8 vjet përpara se subjekti të ishte pjesë e sistemit gjyqësor dhe, për rrjedhojë, krijimi i të ardhurave nuk mund të ketë qenë nga përdorimi i përfitimeve të paligjshme për shkak të ushtrimit të funksionit të magjistratit të bashkëshortes; (ii) faktit që në kohën e krijimit të pjesës më të madhe të të ardhurave, bashkëshorti i subjektit nuk e gëzonte statusin e personit të lidhur me subjektin të rivlerësimit, në kuptim të ligjit nr. 84/2016 dhe, po kështu, nuk mbarte detyrimin për deklaram në kuptim të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2013 dhe, për pasojë, nuk kishte ndonjë detyrim ligjor të tregojë i kujdesshëm, deri në nivelin e ruajtjes së dokumentacionit që provon ligjshmërinë e të ardhurave të tij në atë kohë, përveç se, për sa kërkohej nga organet kompetente apo për aq sa e ka çmuar të nevojshme sipas kujdesit të çdo qytetari normal; (iii) moskonsiderimit të pakësimit të shumës 600.000 lekë në vitin 2012 (referuar arsyetimit në pikën 8.20), sikundër ka deklaruar subjekti me vullnetin e tij në procesverbalin e ILDKPKI-së të datës 23.2.2016, çka do të bënte që balanca negative të reduktohej në shumën 1.048.646 lekë.

7.42. Një detaj tjetër që vlen të mbahet në konsideratë është edhe fakti se nga hetimi i kryer subjekti dhe personi i lidhur nuk rezultojnë ta kenë përdorur shumën *cash* prej 4.000.000 lekësh për të investuar në të tjera pasuri, gjë e cila do të çonte në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e tyre, përveçse për blerjen e automjetit me targa ***. Ky i fundit, nisur nga modeli të cilit i përket⁵⁶ dhe pasqyrimin të kësaj targe në ekstraktin e QKB-së të aktivitetit të bashkëshortit, duket të jetë në funksion të aktivitetit tregtar që ushtron bashkëshorti i subjektit. Po kështu, siç rezultoi nga hetimi, edhe disa prej automjeteve të tjera të analizuar nga Komisioni, konkretisht me targa *** dhe me targa ***⁵⁷, rezultuan të jenë në përmbushje të ushtrimit të aktivitetit tregtar të bashkëshortit të subjektit.

⁵⁴Shuma 6.058.414 lekë për vitet 2001-2006; shuma 416.815 lekë për vitin 2011; shuma 2.042.120 lekë për vitet 2007, 2008, 2009, 2010, 2012 dhe 2013.

⁵⁵Për periudhën 2001– 2013.

⁵⁶Referuar dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRr-ja me shkresën nr. *** prot., datë 26.12.2019, bëhet fjalë për furgon për transport mallrash.

⁵⁷Referuar dokumentacionit të përcjellë nga DPSHTRr-ja me shkresën nr. ***, datë 26.12.2019, bëhet fjalë respektivisht për furgon dhe autokarro për transport privat mallrash.

7.43. Në përfundim të sa më lart, Komisioni vlerëson se mungesa e të ardhurave financiare, shoqëruar me dokumentacion ligjor justifikues, nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, në shumën prej 1.648.646 lekësh, për krijimin jo vetëm të pasurive të deklaruara në DPV-në e vitit 2013 (përpara martesës ligjore), por edhe të blerjes së pasurive të tjera dhe kryerjes së shpenzimeve përpara vitit 2013, të shtrira të gjitha këto në një periudhë 13-vjeçare (2001 – 2013), faktet dhe provat rrethanore, bazuar në parimin e proporcionalitetit, të krijojnë bindjen se kjo mungesë nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe të përbëjnë, për pasojë, një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra.

8. Automjete të tjera në emër të subjektit dhe/ose personit të lidhur/bashkëshortit të subjektit

- *Automjeti me targa ***, në emër të subjektit*

8.1. Në DPV-në e vitit 2008, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar blerje automjeti në mars të vitit 2008. Vlera: 380.000 lekë. Pjesa takuese: 50%. Burimi i krijimit: kredi në “Tirana Bank”, Lushnjë. Në DPV-në e vitit 2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi shitjen e këtij automjeti, me kontratën nr. ***, datë 23.1.2010, në shumën 300.000 lekë, pjesa takuese 50%. Në pyetësin standard, subjekti ka deklaruar blerjen në vitin 2008, të automjetit tip “Ford Fiesta”, me targa ***. Automjeti ka qenë në bashkëpronësi të subjektit dhe shtetasit G.Sh. (vëllai i subjektit). Vlera e blerjes 380.000 lekë, shumë e cila është marrë kredi në “Tirana Bank”. Automjeti është shitur në vitin 2010, në vlerë 300.000 lekë, pagesa është bërë menjëherë. Subjekti deklaroi se nuk e disponon kontratën e blerjes.

8.2. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRr-ja⁵⁸, rezulton se ky automjet ka qenë i regjistruar në emër të shtetasve Natasha dhe G.Sh., blerë me kontratën nr. ***, datë 19.3.2008, me palë shitëse shtetasi R.R. dhe palë blerëse Natasha dhe G.Sh., me çmim 380.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Nga kontrolli i kryer në AMF referuar policave të sigurimit, rezulton se shtetasit G. dhe Natasha Shallapi kanë prerë një policë sigurimi në datën 15.10.2009 me afat 15.10.2009 – 14.10.2010. Nga hetimi i Komisionit, rezultoi se pranë zyrës së noteres publike E.S.⁵⁹, është lidhur kontrata e shitjes së automjetit, nr. ***, datë 23.1.2010, me palë shitëse Natasha dhe G.Sh., kundrejt çmimit 300.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

8.3. Duke qenë se në kontratën e shitjes së këtij automjeti, rezulton si palë shitëse edhe shtetasi G.Sh., me anë të pyetësit nr. 2⁶⁰, subjektit iu kërkua të deklarojë sa ka qenë kontributi financiar i tij dhe shtetasit G.Sh. Në përgjigje⁶¹ subjekti shprehet se ky automjet është blerë me kredi bankare të marrë prej tij dhe shtetasi G.Sh. nuk ka kontribuar në blerje.

8.4. Në dokumentacionin e përcjellë nga “Tirana Bank”⁶² është administruar kontrata e kredisë bankare konsumatore nr. ***, datë 26.12.2007, me kredimarrës Natasha Shallapi, në shumën

⁵⁸Shkresë nr. *** prot., datë 24.12.2020.

⁵⁹Shkresë protokolluar në Komision me nr. ***, datë 24.6.2020.

⁶⁰E-mail datë 3.12.2019, ora 10:33.

⁶¹E-mail datë 16.12.2020, ora 15:58.

⁶²Shkresë nr. *** prot., datë 9.12.2020.

400.000 lekë me qëllim për nevoja personale të kredimarrësit. Në lëvizjet e llogarisë, konstatohet se kjo kredi është disbursuar në datën 26.12.2007 dhe në të njëjtën datë subjekti ka tërhequr shumën 394.000 lekë dhe sipas deklarimeve të tij në DPV-në e vitit 2008, kjo shumë ka shërbyer si burim për blerjen e automjetit në mars të vitit 2008.

8.5. Referuar gurmës “d”, të nenit 4, të ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar, subjektet detyrohen të deklarojnë *vlerën e likuiditeteve, gjendje në cash jashtë sistemit bankar, në llogari rrjedhëse, në depozitë, në bono thesari dhe huadhënie, në lekë ose në valutë të huaj*. Subjekti duhet të kishte deklaruar shumën e tërhequr të kredisë, ndërkohë që në DPV-në e vitit 2007, nuk janë deklaruar shtesa apo pakësime të likuiditeteve *cash*.

Por, duke qenë se: (i) rezulton e provuar se në DPV-në e vitit 2008 (gjithashtu edhe në pyetësin standard), subjekti i rivlerësimit për blerjen e këtij automjeti ka deklaruar si burim krijimi kredinë e marrë në “Tirana Bank”; (ii) kjo kredi është disbursuar në datën 26.12.2007 (me një diferencë prej 2 muajsh nga data e emërimit për herë të parë të subjektit) dhe është tërhequr nga llogaria po në datën 26.12.2007, ndërkohë që automjeti është blerë më 19.3.2008; (iii) vlera e kredisë është përafërsisht në shumën që ka kushtuar ky automjet, Komisioni vlerëson se nuk ka dyshime që shuma e tërhequr nga disbursimi i kësaj kredie ka shërbyer si burim krijimi për blerjen e këtij automjeti në mars të vitit 2008 edhe pse rezultojnë pasaktësi në deklarim në lidhje me likuiditetet *cash* (shtesa) të pa deklaruara nga subjekti në DPV-në e vitit 2007.

8.6. Sa më lart, Komisioni e konsideroi shumën e tërhequr nga kredia si burim për blerjen e automjetit dhe kreu analizën financiare për vitin 2008, nga ku rezultoi se subjekti ka pasur burime të ligjshme financiare për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2008.

Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: (i) *ka mospërputhje midis deklaratave periodike vjetore e kontratës së shitjes dhe përgjigjeve në pyetësor, pasi bazuar në deklaratat periodike të vitit 2008 dhe 2010, si edhe në kontratën e shitjes, pjesa takuese e subjektit e këtij automjeti është 50%, ndërsa në pyetësin nr. 2 subjekti deklaroi se shtetasi Gentian Shallapi nuk ka kontribuar financiarisht; (ii) subjekti ka kryer deklarim të pasaktë lidhur me gjendjen e likuiditeteve cash jashtë sistemit bankar, pasi nuk ka deklaruar në DPV-në e vitit 2007 shumën e tërhequr të kredisë, si shtesë e gjendjes cash, detyrim që lind bazuar në nenin 4, pika “d”, e ligjit nr. 9049, datë 10.4.2003, i ndryshuar.*

8.7. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se konstatimet e Komisionit janë të drejta dhe se “shënimi 50%” ka qenë një pasaktësi prej tij për të deklaruar bashkëpronësinë juridike që ekzistonte në bazë të kontratës së blerjes. Mosdeklarimi i gjendjes së *cash* në DPV-në e vitit 2007 është një pasaktësi, e cila ka ndodhur për shkak se shuma është tërhequr vetëm 4 ditë përpara mbylljes së periudhës 31.12.2007 dhe ka qenë viti i parë që subjekti përpilonte një deklaratë periodike vjetore. Në përfundim, subjekti deklaroi se pasaktësitë në DPV-të vjetore,

kur ato nuk janë kryer me qëllim fshehjen e pasurisë nuk përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore, duke sjellë si referencë disa vendime të Kolegjit⁶³.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

8.8. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provave shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

8.9. Sikundër u trajtua më lart, pasaktësitë në deklaratimet periodike të pasurisë nuk përbëjnë shkak të veçuar për të ngarkuar subjektin me përgjegjësi disiplinore. Për sa kohë këto pasaktësi dhe mospërputhje nuk lidhen me fshehjen e ndonjë pasurie dhe për sa kohë nga hetimi nuk ka rezultuar asnjë e dhënë tjetër që të mund të vinte në dyshim deklaratimet e mësipërme, Komisioni vlerëson se mbështetur në parimin e proporcionalitetit dhe objektivitetit, si dhe bazuar në jurisprudencën e Kolegjit, nuk mund të kualifikohen si asnjë prej situatave të parashikuara nga neni D i Aneksit të Kushtetutës dhe neni 33, pika 5, e ligjit nr. 84/2016, si dhe të përbëjnë, për pasojë, shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra sipas nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016.

- *Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, në emër të personit të lidhur/bashkëshortit*

8.10. Në DPV-në e vitit 2014, personi i lidhur, ka deklaruar blerje automjeti “Mercedes-Benz”, në Gjermani, me targa ***, në vlerën 4.300 euro dhe shpenzimet doganore në shumën 383.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Më tej, deklaroi shitjen e këtij automjeti në vlerën 9.000 euro. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

8.11. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja⁶⁴, nuk rezultojnë të dhëna për këtë automjet. Gjithashtu, nga kontrolli i kryer në AMF, ky automjet nuk figuron në pronësi të shtetasit A.P. Në pyetësorin standard, subjekti deklaroi se në vitin 2014, bashkëshorti ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, për një vlerë 4.300 euro, në Gjermani dhe pagesa e doganës në vlerën 383.000 lekë. Automjeti është shitur në vitin 2014, për një vlerë 9.000 euro. Këtë automjet fillimisht ia ka shitur shtetasit M.C., për një vlerë 12.000 euro. Pas blerjes, blerësi kishte pretendime lidhur me automjetin dhe nuk ishte dakord për veprimin e kryer. Automjeti është rishitur për një vlerë 9.000 euro, që është vlera reale e shitjes dhe e deklaruar në deklaratën periodike. Blerë me të ardhurat nga kursimet e bashkëshortit. Pagesa është bërë menjëherë me blerjen e automjetit. E pyetur lidhur me këtë automjet në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI në datën 29.1.2016, subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion lidhur me blerjen dhe shitjen e këtij automjeti.

8.12. Me kërkesë të Komisionit, Drejtoria e Përgjithshme e Doganave⁶⁵ ka përcjellë deklaratë doganore nr. ***, datë 14.4.2014, marrës A.P., çmim blerje 5.300 euro dhe shpenzime

⁶³Vendimin nr. ***, nr. ***.

⁶⁴Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2019.

⁶⁵Shkresë nr. *** prot., datë 15.12.2020.

doganore 341.448 lekë, pra, në total në vlerën 1.084.879 lekë⁶⁶. Gjithashtu, nga hetimi i Komisionit, rezultoi se pranë zyrës së noterit publik G.B.⁶⁷, është lidhur kontrata e shitjes së këtij automjeti, nr. ***, datë 10.6.2014, me palë shitëse bashkëshorti i subjektit, kundrejt çmimit 12.000 euro, likuiduar jashtë zyrës noteriale. Me anë të pyetësorit nr. 2⁶⁸, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për shitjen përfundimtare të këtij automjeti. Në përgjigje⁶⁹ subjekti sqaron se sikundër ka deklaruar edhe më parë, automjeti në fjalë i është shitur fillimisht shtetasit M.C. në vlerën 12.000 euro. Duke qenë se ky shtetas kishte pakënaqësi lidhur me automjetin, e ka kthyer atë pak ditë pas blerjes dhe ka rimarrë pagesën e kryer prej 12.000 euro. Për këtë veprim nuk është bërë kontratë tjetër noteriale, duke qenë se automjeti do të nxirrej përsëri në shitje, prandaj në momentin e shitjes, pronar dhe palë shitëse e automjetit figuron shtetasi M.C. Vlera finale e shitjes ka qenë 9.000 euro. Subjekti paraqiti kontratën nr. ***, datë 9.9.2014, palë shitëse M.C., palë blerëse Sh.M., vlerë 9.000 euro (ekuivalenti 1.262.610 lekë⁷⁰).

8.13. Komisioni vëren se sipas kontratës nr. ***, datë 9.9.2014, shitësi M.C. ia ka shitur këtë automjet blerësit Sh.M. në vlerën 9.000 euro, por subjekti nuk ka paraqitur dokument provues ligjor lidhur me deklaratimet e tij dhe kthimin e shumës prej 12.000 euro shtetasit M.C., pas lidhjes së kontratës së parë të shitjes në datën 10.6.2014.

8.14. Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁷¹, nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti (diferenca prej 177.731 lekë mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes) dhe, për këtë arsye, vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3, e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës të arkëtuar. Për këtë arsye, në analizën financiare të vitit 2014, u pasqyruan të ardhura nga shitja, të barabarta me koston e blerjes, pra, në vlerën 1.084.879 lekë.

8.15. Për sa i përket burimit të krijimit në pyetësorin standard, subjekti ka deklaruar që ky automjet është blerë me të ardhurat nga kursimet e bashkëshortit. Në DPV-në e vitit 2014, subjekti dhe personi i lidhur/bashkëshorti nuk kanë deklaruar përdorimin e likuiditeteve *cash* për blerjen e automjetit (në fund të vitit 2013 gjendja *cash* e deklaruar nga bashkëshorti ka qenë në shumën 4.000.000 lekë).

8.16. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: *(i) lidhur me ligjshmërinë e burimit financiar për blerjen e këtij automjeti, Komisioni kreu analizën financiare në datën 14.4.2014, nga ku rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për blerjen e automjetit në këtë datë, me një balancë negative prej 1.386.783*

⁶⁶Çmimi 5.300 euro vlerësuar me kursin e këmbimit të pasqyruar në deklaratën doganore, 1 euro = 140.27 lekë. U përfshinë edhe shpenzimet doganore.

⁶⁷Shkresë protokolluar në Komision me nr. ***, datë 10.6.2020.

⁶⁸E-mail datë 3.12.2019, ora 10:33.

⁶⁹E-mail datë 16.12.2020, ora 15:58.

⁷⁰Çmimi 9.000 euro, vlerësuar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 9.9.2014, 1 euro = 140.29 lekë.

⁷¹Shkresë nr. *** prot., datë 13.1.2020.

lekësh; (ii) referuar analizës financiare në datën 31.12.2014, rezultoi se subjekti dhe personi i lidhur nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve gjatë vitit 2014, me një balancë negative prej 352.255 lekësh; (iii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues lidhur me vlerën reale të shitjes së automjetit me targa *** dhe deklarimeve të subjektit për kthimin e shumës prej 12.000 euro shtetasit M.C., pas lidhjes së kontratës së parë të shitjes në datën 10.6.2014; (iv) ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti.

8.17. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme për blerjen e automjetit në datën 14.4.2014, deklaroi se bashkëshorti ka pasur likuiditet të mjaftueshëm për ta përdorur brenda vitit për blerjen e automjetit. Në DPV-në e vitit 2014 ka një pasaktësi, vijoi subjekti, pasi nuk është deklaruar zvogëlimi i gjendjes *cash*, por edhe nëse në një moment e marrim të pandryshuar gjendjen *cash* në fund të vitit 2014, kjo nuk do të thotë që gjatë vitit kjo gjendje s'ka ndryshuar. Më tej, subjekti shpjegoi se përdorimi i termit “kursimet e bashkëshortit” i referohet kursimeve në *cash* që ai dispononte në atë moment dhe jo kursimeve nga data 1.1.2014 – 14.4.2014. Për këtë arsye, përfundoi subjekti, Komisioni duhet të përfshijë në analizën financiare të kryer në momentin e blerjes së automjetit pakësimin e gjendjes *cash* si burim krijimi për blerjen e automjetit, e cila ka qenë më e lartë se vlera e automjetit.

8.18. Lidhur me mungesën e burimeve të ligjshme referuar analizës financiare të vitit 2014, subjekti paraqiti dy variante të analizës financiare. Në variantin e parë subjekti ka konsideruar çmimin e shitjes së automjeteve sipas kontratave⁷², pavarësisht mospagimit të detyrimeve tatimore për fitimin e realizuar, si dhe ka reduktuar shpenzimet e jetesës⁷³ me argumentin se referuar vërtetimit të Bashkisë Lushnjë⁷⁴ rezulton se bashkëshorti ka në bashkëpronësi sipas AMTP-së nr. ***, datë 15.5.1999, pasurinë me titull tokë bujqësore, të cilën e përdor për prodhimin e produkteve bujqësore gjatë vitit për nevojat e tij familjare. Rezultati financiar vjetor i paraqitur në këtë variant është 1.116.677 lekë.

8.19. Në variantin e dytë të analizës financiare, subjekti shpjegoi se duke iu referuar qëndrimit të Komisionit lidhur me çmimin e shitjes së automjeteve, por duke konsideruar reduktimin e shpenzimeve të jetesës, rezultati financiar vjetor është -133.189 lekë, por, më tej, subjekti theksoi se në këtë rezultat nuk është konsideruar: (i) pakësimi i gjendjes *cash* deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së, në shumën 800.000 lekë; (ii) përveç fitimit të vitit bashkëshorti ka disponuar në fund të vitit edhe gjendjen *cash* të aktivitetit, si sigurimet e papaguara për tremujorin e fundit, furnitorët nga faturat e vitit të cilat janë konsideruar shpenzim, si dhe gjendjen *cash* të lënë në shoqëri; (iii) në analizën financiare të Komisionit janë konsideruar më vete shpenzimet e qirasë, si dhe shpenzimet për TPL, ndërkohë që referuar Anketës së Buxhetit të Familjes për vitin 2014, në zërin “shpenzime për banesë, ujë, energji elektrike dhe qira e paguar”, zënë 10.2%, nga llogaritja për këtë vit, ky zë është 67.319 lekë (659.994 * 10.2%), një pjesë e të cilave duhet të shkojnë për mbulimin e shpenzimeve të qirasë; (iv) vlera e sigurimeve TPL duhet të përfshihet në zërin “transport”. Sipas ABF zëri “transport” zë 6.8%

⁷²Nga 1.315.581 lekë në 2.565.447 lekë.

⁷³Nga 659.994 lekë në 440.928 lekë

⁷⁴Vërtetim nr. ***, datë 11.5.2021 dhe vërtetim nr. ***, datë 17.5.2021.

të shpenzimit ose 44.880 lekë ($659.994 \cdot 6.8\%$), që gjithashtu edhe një pjesë e këtij zëri duhet të shkojë për mbulimin e sigurimeve TPL; (v) vlera e shpenzimeve të udhëtimit është përlllogaritur në shumën 269.760 lekë, por është më e vogël, pasi Komisioni ka përlllogaritur të gjitha shpenzimet e udhëtimit të cilat duhet të ndahen në mënyrë proporcionale me personat që subjekti apo bashkëshorti kanë qenë në këto udhëtime.

8.20. Lidhur me mungesën e dokumentacionit ligjor justifikues për sa i përket vlerës reale të shitjes së automjetit me targa ***, subjekti shpjegoi se në vitin 2014 ka përfituar vetëm vlerën 9.000 euro nga shitja e automjetit me targa **. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. **, datë 17.5.2021, të shtetasit M.C. Në përfundim shton se deklarimi i bërë në DPV-në e vitit 2014 pasqyron realitetin dhe nuk është kryer revokimi i kontratës, duke qenë se ishin në kushtet e mirëbesimit dhe se bashkëshorti kishte si qëllim shitjen e këtij automjeti.

8.21. Lidhur me mungesën e dokumentacionit ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e automjetit, subjekti shpjegoi se fitimi i realizuar nga shitja e automjeteve nuk është i tatueshëm.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

8.22. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

8.23. Lidhur me pretendimin e subjektit se për blerjen e automjetit janë përdorur likuiditetet cash të disponuara në fund të vitit 2013, Komisioni vëren se në fund të vitit 2014, gjendja cash ka mbetur e pandryshuar, pasi subjekti dhe bashkëshorti nuk kanë deklaruar në deklaratën periodike vjetore ndryshime të këtyre likuiditeteve. Nga ana tjetër, ky automjet i blerë në datën 14.4.2014 është shitur po gjatë vitit 2014, në shumën 9.000 euro. Nga hetimi administrativ nuk u konstatua ndonjë shpenzim në këtë vlerë dhe, për rrjedhojë, teorikisht, të ardhurat nga kjo shitje mund të kenë shërbyer për të ruajtur të njëjtin nivel të kursimeve në fund të vitit. Për pasojë, Komisioni vlerëson se pretendimi i subjektit është i bazuar.

8.24. Lidhur me pretendimin e subjektit për pakësimin e gjendjes cash në shumën 800.000 lekë, siç është deklaruar në procesverbalin e ILDKPKI-së datë 23.2.2016, Komisioni i qëndron arsyetimit në pikën 8.20.

8.25. Lidhur me pretendimin e subjektit për reduktimin e shpenzimeve të jetesës, Komisioni thekson se për këtë përlllogaritje mbështetet në informacionin zyrtar të INSTAT-it drejtuar ILDKPKI-së dhe këto të dhëna përdoren për të gjitha subjektet e rivlerësimit, për rrjedhojë, ky pretendim vlerësohet i pabazuar dhe këto shpenzime mbeten të pandryshuara në analizën financiare.

8.26. Lidhur me pretendimin e subjektit për rlllogaritje të shpenzimeve të udhëtimit duke i ndarë në mënyrë proporcionale me personat që subjekti apo bashkëshorti kanë qenë në këto udhëtime, Komisioni nuk e mori në konsideratë, për sa kohë këto udhëtime janë kryer me

automjetet në pronësi të bashkëshortit të subjektit dhe nuk u provuan me dokumentacion justifikues hyrje-daljet në pikat kufitare të këtyre personave në të njëjtin moment dhe po me këto automjete.

8.27. Lidhur me pretendimin e subjektit se fitimi i realizuar nga shitja e automjeteve nuk është i tatueshëm, referuar arsyetimit në paragrafët 6.11 - 6.14 lidhur me fitimin e realizuar nga shitja e automjeteve dhe mosplotësimin e kushteve të parashikuara nga pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, shuma prej 177.731 lekësh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes nuk konsiderohet si e ardhur në analizën financiare, qëndrim ky i konsoliduar tashmë edhe nga praktika e Kolegjit të Posaçëm të Apelit.

8.28. Në përfundim, subjekti dhe personat e lidhur rezultojnë me një mungesë burimesh të ligjshme në vlerën 352.255 lekë për blerjen e pasurive dhe kryerjen e shpenzimeve në vitin 2014.

- *Automjet tip “Hyundai”, me targa ***, në emër të personit të lidhur/bashkëshortit*

8.29. Në DPV-në e vitit 2015 personi i lidhur ka deklaruar blerje automjeti tip “Hyundai”, me targa ***, në vlerën 100 euro. Pjesa takuese: 100%. Më tej, deklaroi shitjen e këtij automjeti në vlerën 100.000 lekë. Nuk është deklaruar burimi i krijimit.

8.30. Sipas dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja⁷⁵ rezulton se bashkëshorti i subjektit ka të regjistruar automjetin me targa ***. Sipas deklaratës doganore nr. ***, datë 8.1.2015⁷⁶, ky automjet ka kushtuar 100 euro dhe shpenzimet doganore janë në shumën 24.342 lekë, në total 38.356 lekë⁷⁷. Nga kontrolli i kryer në AMF, referuar policave të sigurimit, ky automjet rezulton në pronësi të z. A.P. prej vitit 2015 e në vazhdim. Me anë të pyetësorit nr. 2⁷⁸, subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për shitjen e automjetit. Në përgjigje⁷⁹, subjekti paraqiti kontratën nr. ***, datë 2.12.2015, sipas së cilës me palë shitëse A.P. dhe palë blerëse shtetasi M. N., automjeti është shitur në vlerën 100.000 lekë, likuiduar jashtë zyrës noteriale.

8.31. Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁸⁰ nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti (diferenca prej 61.644 lekësh mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes) dhe për këtë arsye vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të pikës 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar. Për këtë arsye, në analizën financiare të vitit 2017, u pasqyruan të ardhura nga shitje të barabarta me koston e blerjes, pra shuma 38.356 lekë.

8.32. Nga faktet e analizuar më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën

⁷⁵Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2019.

⁷⁶Shkresë nr. *** prot., datë 15.12.2020.

⁷⁷Çmimi 100 euro vlerësuar me kursin e këmbimit të pasqyruar në deklaratën doganore, 1 euro = 140.14 lekë. U përfshinë edhe shpenzimet doganore.

⁷⁸E-mail datë 3.12.2019, ora 10:33.

⁷⁹E-mail datë 16.12.2020, ora 15:58.

⁸⁰Shkresë nr. ***, datë 13.1.2020.

e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: “Ka mungesë dokumentacioni ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti”.

8.33. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: “Fitimi i realizuar nga shitja e automjeteve nuk është një e ardhur e tatueshme. Gjithashtu, për shkak të riparimeve apo shpenzimeve që mund të jenë kryer për këtë automjet nuk mund të thuhet me saktësi nëse në rastin konkret është realizuar apo jo fitim”.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

8.34. Referuar arsyetimit në paragrafët 6.11 - 6.14 lidhur me fitimin e realizuar nga shitja e automjeteve dhe mosplotësimin e kushteve të parashikuara nga pika 3, e nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germa “b”, e pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, shuma prej 61.644 lekësh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes nuk konsiderohet si e ardhur në analizën financiare, qëndrim ky i konsoliduar tashmë edhe nga praktika e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit.

- *Automjet tip “Mercedes Sprinter 316 CDI”, vit prodhimi 2010, në emër të personit të lidhur/bashkëshortit*

8.35. Në DPV-në e vitit 2017 personi i lidhur ka deklaruar blerje automjeti tip “Mercedes-Benz” në Gjermani me nr. shasie ***, datë 18.5.2017, vlera sipas kontratës 10.800 euro, kthyer TVSH 1.726 euro (vlera reale e blerjes pas kthimit të TVSH-së 9.074 euro) dhe pagesa doganore 303.000 lekë. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti deklaroi: blerë me hua pa interes. Më tej, subjekti deklaroi shitjen e këtij automjeti me kontratën nr. ***, datë 11.9.2017, në shumën 14.000 euro. Në DPV-në e vitit 2017 subjekti ka deklaruar hua pa interes, marrë e shlyer brenda vitit pas shitjes së automjetit në vlerën 11.000 euro. Në pyetësonin standard subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në vitin 2017 bashkëshorti i saj ka blerë një automjet në Gjermani në vlerën 10.800 (më pas është rimbursuar TVSH) dhe pagesë doganore 303.000 lekë. Pagesa është kryer menjëherë. Automjeti është shitur në vitin 2017 për vlerën 14.000 euro. Si burim krijimi subjekti deklaroi huan e marrë nga shtetasi E.Z. Bashkëlidhur pyetësonit standard, subjekti ka paraqitur një faturë të datës 18.5.2017, nga shteti gjerman në vlerën 10.800 euro për automjetin tip “Mercedes Sprinter 316 CDI”, si dhe kontratën e shitjes nr. ***, datë 11.9.2017, me palë shitëse A.P. dhe palë blerëse shoqëria “K.” sh.p.k. në shumën 14.000 euro dhe likuidimi i vlerës do të bëhet nëpërmjet bankës.

8.36. Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja⁸¹, ky automjet nuk rezultoi i regjistruar në pronësi të bashkëshortit të subjektit. Nga kontrolli i kryer në AMF, sipas policave të sigurimit, ky automjet me targa *** rezultoi në pronësi të shoqërisë “K.” sh.p.k., prej vitit 2017 e në vazhdim. Drejtoria e Përgjithshme e Doganave⁸² ka përcjellë deklaratën doganore

⁸¹Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2019.

⁸²Shkresë nr. *** prot., datë 15.12.2020.

nr. ***, datë 22.5.2017, ku figuron marrës shtetasi A.P., çmimi i blerjes 10.800 euro dhe shpenzime doganore 302.736 lekë.

8.37. Referuar llogarisë së bashkëshortit të subjektit në “ABI Bank”⁸³, në datën 18.7.2017, është kredituar në llogari shuma prej 1.709,37 euro me përshkrimin “Incoming fund transfer, rueckerstattung kaution B.A.H.”⁸⁴.

8.38. Sa më sipër, në analizën financiare kostoja e blerjes së këtij automjeti u paraqit në vlerën 1.530.244 lekë, e përbërë nga: (1) pagesa 10.800 euro në Gjermani, me burim huan në vlerën 11.000 euro⁸⁵ nga shtetasi E.Z.; (2) shpenzime doganore në shumën 302.736 lekë, të paguara në datën 22.5.2015; dhe (3) kthimi i TVSH-së në vlerën 1.709.37 euro.

8.39. Lidhur me huan në vlerën 11.000 euro, dhënë nga shtetasi E.Z. - duke qenë se shtetasi E.Z. konsiderohet person tjetër i lidhur në kuptim të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, me anë të pyetësorit nr. 2⁸⁶ subjektit iu kërkua të paraqesë dokumentacion ligjor justifikues për të vërtetuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua, si dhe dokumentacion ligjor justifikues për konfirmimin e kësaj marrëdhënieje nga ana e tij. Në përgjigje⁸⁷, subjekti paraqiti deklaratën noteriale nr. ***, datë 11.12.2020, lëshuar nga shtetasi E.Z., si edhe statement të llogarisë bankare pranë “ABI Bank”, ku pasqyrohen të ardhurat nga paga si drejtor i kësaj banke, në degën Lushnjë, të shtetasit E.Z. për periudhën nëntor 2011 – prill 2017.

8.40. Sipas deklaratës noteriale me objekt “deklarim mbi njohje detyrimi”, lëshuar nga shtetasi E.Z., në maj të vitit 2017, i ka dhënë hua pa interes në shumën 11.000 euro shtetasit A.P. Për shkak të lidhjes familjare dhe marrëdhënies së besimit reciprok nuk kanë lidhur kontratë me shkrim për dhënien e huas, shlyer plotësisht brenda vitit 2017.

8.41. Për të analizuar faktin nëse personi tjetër i lidhur/E.Z. justifikon me burime të ligjshme shumën prej 11.000 euro, u konsideruan të ardhurat e ligjshme të tij në raport me shpenzimet e konsumuara për jetesë, nga ku konstatohet se për periudhën nëntor 2011 – prill 2017, të ardhurat nga paga dhe shpërblimet e personit tjetër të lidhur/E.Z. kanë qenë në shumën 7.228.436 lekë, ndërkohë që shpenzimet jetike për të njëjtën periudhë u përlllogaritën në shumën 1.062.824 lekë. Diferenca e mbetur prej 6.165.612 lekësh duket e mjaftueshme për dhënien hua të shumës 11.000 euro (ekuivalenti 1.485.330 lekë⁸⁸).

8.42. Referuar lëvizjeve të llogarive bankare të subjektit në “Raiffeisen Bank” konstatohet se në datën 30.4.2017 subjekti ka pasur gjendje në llogarinë rrjedhëse shumën prej 1.610.017 lekësh. Me anë të pyetësorit nr. 5⁸⁹, subjektit iu kërkua të japë shpjegime lidhur me arsyet e marrjes së kësaj huaje ndërkohë që dispononte një shumë të barasvlershme në llogarinë e tij rrjedhëse në lekë në “Raiffeisen Bank”. Në përgjigje⁹⁰, subjekti deklaroi se kjo hua është marrë nga bashkëshorti dhe se do të shlyhej për një afat të shkurtër kohor, pasi ky i fundit kishte në

⁸³Shkresë nr. *** prot., datë 23.12.2019.

⁸⁴Referuar kërkimit *online*, në gjuhën shqipe *rueckerstattung* përkthehet “rimbursim”, ndërsa *kaution* përkthehet “depozitë”.

⁸⁵Çmimi 9.090,63 euro (10.800 euro minus 1.709,37 euro) vlerësuar me kursin e këmbimit të pasqyruar në deklaratën doganore, 1 euro = 135.03 lekë. U përfshinë edhe shpenzimet doganore.

⁸⁶E-mail datë 3.12.2019, ora 10:33.

⁸⁷E-mail datë 16.12.2020, ora 15:58.

⁸⁸Shuma 11.000 euro u vlerësua me të njëjtin kurs këmbimi si automjeti.

⁸⁹E-mail datë 25.1.2021, ora 10:05.

⁹⁰E-mail datë 28.1.2021, ora 9:42.

plan të shiste edhe furgonin tjetër që kishte në pronësi, si dhe duke konsideruar faktin se huadhënësi nuk kishte në plan të përdorte në atë periudhë shumën e dhënë hua.

8.43. Komisioni hetoi nëse subjekti gjendej në kushtet e konfliktit të interesit me shtetasin E.Z.⁹¹ dhe nga përgjigjja e administruar nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë⁹² rezultoi se ky shtetas nuk ka qenë person nën hetim, i pandehur apo i dyshuar/kallëzuar në kallëzime/procedime penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit dhe as nga kjo prokurori. Gjithashtu, nga hetimi i Komisionit rezultoi se personi tjetër i lidhur/huadhënësi ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme për dhënien e huas.

8.44. Për sa i përket shlyerjes së kësaj huaje, Komisioni kreu analizën financiare të vitit 2017, nga ku rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur burime të ligjshme financiare për shlyerjen e huas në vitin 2017.

8.45. Lidhur me pagesën e shpenzimeve doganore në vlerën 302.736 lekë të paguara në datën 22.5.2017 - në dokumentacionin e përcjellë nga “Credins Bank”⁹³ konstatohet se në datën 22.5.2017, personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit ka kryer një depozitim në llogarinë e tij bankare në vlerën 302.967 lekë me përshkrim “derdhje cash, arkëtoi A.P. për pagesë dogane” dhe në të njëjtën datë është kryer pagesa e detyrimeve doganore.

8.46. Për sa i përket shitjes së këtij automjeti, noter G.B.⁹⁴ ka përcjellë kontratë shitjeje nr. ***, datë 11.9.2017, blerës shoqëria “K.” sh.p.k., vlera 14.000 euro, ku specifikohet se shuma do të likuidohet në rrugë bankare. Komisioni konstaton se në datën 14.9.2017, në llogarinë e bashkëshortit të subjektit në “ABI Bank” është transferuar shuma 14.000 euro me përshkrimin “likuidim detyrimi për blerje automjeti K. sh.p.k.”. Ekuivalenti në lekë i kësaj shume është 1.867.740⁹⁵ lekë. Në përgjigjen e përcjellë nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë⁹⁶ nuk evidentohet pagesa e detyrimeve tatimore për vlerën e fitimit të realizuar nga shitja e këtij automjeti (diferenca prej 337.496 lekësh mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes) dhe për këtë arsye vlera e fitimit të realizuar vlerësohet si e ardhur e paligjshme në kuptim të nenit D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 30 të ligjit nr. 84/2016 dhe kjo vlerë i zbritet të ardhurës së arkëtuar. Për këtë arsye, në analizën financiare të vitit 2017, u pasqyruan të ardhura nga shitja, të barabarta me koston e blerjes, pra 1.530.244 lekë.

8.47. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: “(i) nga analiza financiare e periudhës 1.1.2017 - 22.5.2017, për të ardhurat, shpenzimet dhe pasuritë rezultoi se subjekti dhe personat e lidhur kanë pasur mungesë burimesh të ligjshme në shumën 270.605 lekë, për pasojë nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për pagesën e shpenzimeve doganore;

⁹¹Shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2021.

⁹²Shkresë nr. *** prot., datë 29.1.2021.

⁹³Shkresë nr. ***, datë 21.1.2020.

⁹⁴Shkresë datë 9.6.2020, protokolluar nga Komisioni në datën 10.6.2020, nr. *** prot.

⁹⁵Çmimi 14.000 euro vlerësuar me kursin e këmbimit të Bankës së Shqipërisë datë 11.9.2017, 1 euro = 133.41 lekë.

⁹⁶Shkresë nr. *** prot., datë 13.1.2020.

(ii) ka mungesë të dokumentacionit ligjor justifikues për pagesën e tatimit mbi të ardhurat e përfituara nga shitja e këtij automjeti”.

8.48. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se në lidhje me pagesën e shpenzimeve doganore 302.736 lekë të paguara në datën 22.5.2017, në analizën financiare Komisioni ka marrë në konsideratë vetëm pjesën përpjesëtimore të fitimit të realizuar në vitin 2017, ndërkohë që bashkëshorti i saj për kryerjen e pagesës ka përdorur gjendjen e likuiditetit cash nga aktiviteti si person fizik dhe, për këtë arsye, rezultoi edhe balanca negative në datën 22.5.2017. Vetëm shuma e arkëtimeve cash për aktivitetin nga data 1.1.2017 deri më 22.5.2017 është 3.022.288 lekë, vijoi subjekti dhe paraqiti faturën e kasës ku pasqyrohet totali i xhiros për periudhën në fjalë. Meqenëse ndërmjet llogarisë së personit fizik dhe vetë individit nuk ka një ndarje të qartë, përfundoi subjekti, për pagesën e mësipërme është përdorur likuiditeti i krijuar në arkë nga shitja e mallrave, e cila më pas është kthyer. Subjekti kërkon që Komisioni në marrjen e vendimit ta vlerësojë këtë diferencë hipotetike bazuar në parimin e proporcionalitetit.

8.49. Më tej, lidhur me të ardhurat nga shitja e automjeteve, subjekti mban të njëjtin qëndrim lidhur me fitimin e tatueshëm të realizuar nga shitja e automjeteve, ku gjithashtu pretendon se për shkak të riparimeve apo shpenzimeve që mund të jenë kryer nuk mund të thuhet me saktësi sa është fitimi i realizuar.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

8.50. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratat e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se raporti i arkëtimeve të gjeneruara nga kasa për periudhën 1.1.2017-22.5.2017, në shumën 3.022.288 lekë, tregon për një mundësi të posedimit të likuiditeteve cash nga ana e personit të lidhur. Duke konsideruar volumin e shitjeve dhe llojin e aktivitetit, ku veprimtaria e personit juridik si person fizik është e vështirë të ndahet qartazi nga aktiviteti dhe administrimi i këtij aktiviteti prej individit, posedimi dhe përdorimi i shumave apo të ardhurave të krijuara nga ky aktivitet, shpesh herë marrin formën e likuiditeteve të vëna në shërbim të nevojave familjare, Komisioni e vlerëson bindës shpjegimin e subjektit.

8.51. Ndërkohë, referuar arsyetimit lidhur me fitimin e realizuar nga shitja e automjeteve dhe mosplotësimin të kushteve të parashikuara në pikën 3, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës dhe germës “b”, të pikës 5, të nenit 33, të ligjit nr. 84/2016, shuma prej 337.496 lekësh, që përbën diferencën mes çmimit të shitjes dhe çmimit të blerjes nuk konsiderohet si e ardhur në analizën financiare.

*- Automjet tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, në emër të personit të lidhur/bashkëshortit*

8.52. Në DPV-në e vitit 2017, personi i lidhur ka deklaruar blerje automjeti tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, sipas faturës tatimore të shitjes datë 30.11.2017, në vlerën 3.600 euro. Pjesa takuese: 100%. Si burim krijimi subjekti deklaroi: të ardhurat nga shitja e automjetit tip “Mercedes Sprinter 316 CDI” (vit prodhimi 2010 në vlerën 14.000 euro). Në pyetësinë

standard, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se në vitin 2017 bashkëshorti i saj ka blerë automjetin tip “Mercedes-Benz”, me targa ***, në vlerën 3.600 euro. Pagesa është kryer menjëherë. Burimi i krijimit: blerë më të ardhurat nga shitja e automjetit me targa ***.

8.53. Referuar dokumentacionit të administruar nga DRSHTRR-ja⁹⁷ rezulton se bashkëshorti i subjektit ka të regjistruar automjetin me targa ***, i cili është blerë nga bashkëshorti i subjektit me faturën tatimore të shitjes nr. ***, datë 30.11.2017, në vlerën 3.600 euro, nga shitësi “B.K.” person fizik (kursi i euros 1.330). Sipas deklaratës doganore datë 7.10.2017, automjeti ka kushtuar 2.800 euro dhe shpenzimet doganore janë në shumën 133.126 lekë, zhdoganuar nga “B.K.” person fizik. Nga kontrolli i kryer në AMF, referuar policave të sigurimit, ky automjet rezulton në pronësi të z. A.P. për periudhën 2017 – 3.12.2020, më pas figuron në emër të shtetasit A.H.

8.54. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se pranë zyrës së noterit publik E.H.⁹⁸ është lidhur kontrata e shitjes së këtij automjeti me nr. ***, datë 30.6.2020, me palë shitëse bashkëshorti i subjektit, kundrejt çmimit 3.500 euro. Lidhur me burimin e krijimit, Komisioni konstatoi se automjeti me targa *** është shitur me kontratën nr. ***, datë 30.11.2017, me çmim 1.500.000 lekë dhe po në të njëjtën datë është lidhur kontrata për blerjen e automjetit me targa ***, me vlerë 3.600 euro.

8.55. Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar saktë dhe në përputhje me ligjin, si dhe verifikohet burimi i ligjshëm i blerjes së kësaj pasurie.

9. Lidhur me deklaratimet e gjendjes së likuiditeteve *cash*, ndër vite

Lidhur me deklaratimet e gjendjes së likuiditeteve cash, ndër vite, nga subjekti

9.1. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2007, subjekti ka deklaruar gjendje shumën 600.000 lekë në banesë. Komisioni vëren se në deklaratat periodike vjetore 2007 - 2018, subjekti nuk ka deklaruar shtesë apo pakësim të kësaj shume. Po kështu, në deklaratën Vetting nuk janë deklaruar gjendje likuiditetesh cash jashtë sistemit bankar.

9.2. Komisioni, me pyetësorin nr. 2 i kërkoi shpjegime subjektit, si dhe burimin e krijimit të shumës prej 600.000 lekësh. Në përgjigje⁹⁹, subjekti deklaroi se kjo shumë është deklaruar gjendje cash në deklaratën para fillimit të detyrës, burimi i krijimit janë kursimet e të ardhurave nga puna në “Tirana Bank” dhe të ardhurat nga Shkolla e Magjistraturës. Këto kursime janë shpenzuar në vitin 2013, por janë harruar të deklarohen si shpenzim për atë vit. Subjekti theksoi se ky fakt është sqaruar edhe para ILDKPKI-së në shpjegimet e dhëna në vitin 2016. Komisioni vëren se në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI, në datën 23.2.2016, lidhur me gjendjen cash, subjekti deklaroi se ka harruar të deklarojë shpenzimet në vitin 2013 në shumën 600.000 lekë nga kursimet dhe në vitin 2014 në shumën 800.000 lekë nga gjendja cash e bashkëshortit.

⁹⁷Shkresë nr. *** prot., datë 26.12.2019.

⁹⁸Shkresa e protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 7.12.2020.

⁹⁹E-mail datë 16.12.2020, ora 15:58.

9.3. Komisioni kreu analizën financiare për periudhën 24.6.2004 – 31.12.2007 për pasuritë, të ardhurat, shpenzimet, detyrimet e subjektit të rivlerësimit, nga ku rezultoi një balancë negative në shumën 294.772 lekë.

9.4. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: “Subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme të mjaftueshme për kryerjen e shpenzimeve dhe shtesën e kursimeve gjatë kësaj periudhe me një balancë negative prej 294.772 lekësh.

9.5. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, lidhur me balancën negative për periudhën 24.6.2004 - 31.12.2007, deklaroi se: (i) shumat e kredisë janë tërhequr nga llogaria dhe janë përdorur një pjesë për shpenzime konsumi dhe një pjesë është mbajtur si gjendje cash në familje, nga ku janë bërë pagesat e kësteve duke respektuar afatet për mosmarrje të penalizimit nga ana e bankës. Nga shuma e kredisë së disbursuar në llogarinë likuiduese në vlerën 600.000 lekë, për shpenzime është përdorur vetëm shuma prej 300.000 lekësh. Diferenca e kredisë së papërdorur në shumën 300.000 lekë plus gjendja e trashëguar nga paga në vlerën 89.000 lekë, janë përdorur për të paguar këstet e kredisë që do të maturoheshin në vazhdim, pasi gjendja mbahej cash; (ii) në analizën financiare duhet të përfshihen edhe interesat bankare të evidentuara në llogarinë bankare në “Tirana Bank” në shumën prej 5.663 lekësh; (iii) pagat për këtë periudhë kanë qenë në shumën 726.908 lekë.

9.6. Në përfundim, në vijim të pretendimeve të tij, subjekti deklaroi se ka pasur burime të ligjshme për krijimin e kursimeve në shumën 600.000 lekë, pasi nga analiza financiare rezulton një balancë pozitive në shumën 19.937 lekë.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

9.7. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, Vetting; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se:

9.8. Kredia në shumën 600.000 lekë është marrë në datën 4.8.2005, pra, përpara se subjekti të fillonte detyrën dhe të kryente deklaratime periodike në ILDKPKI, nga ku do t’i lindte detyrimi për të deklaruar me saktësi në vitin përkatës, si dhe qëllimin e përdorimit të kredisë. Për këtë arsye, Komisioni e vlerëson të bazuar pretendimin e subjektit dhe paraqiti në analizën financiare vlerën 300.000 lekë si shumë të shpenzuar për kredinë e marrë në datën 4.8.2005.

9.9. Për sa i përket pretendimit për pasqyrimin në analizën financiare të interesave bankare, Komisioni, pasi verifikoi lëvizjet e llogarive bankare në “Tirana Bank”, e vlerësoi si të bazuar këtë pretendim dhe përfshiu në analizën financiare të ardhura nga interesat bankare në shumën 5.663 lekë.

9.10. Lidhur me shumën e pagave të paraqitur në analizën financiare, Komisioni thekson se i është referuar transfertave të pagës në bankë, të cilat kanë qenë në vlerën 618.031 lekë. Për këtë arsye, pretendimi i subjektit u vlerësua i pabazuar.

9.11. Në lidhje me mosdeklarimin e pakësimit të gjendjes cash në vitin 2013 në shumën 600.000 lekë, Komisioni vlerëson që nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare për sa kohë që ky pakësim nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse, por çmon të theksojë se subjekti e ka deklaruar vullnetarisht këtë pasaktësi në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 23.2.2016, në përgjigje të pyetjes nr. 12 - nëse ka për të deklaruar pasuri, detyrime, biznes apo interesa të padeklaruara më parë në deklaratat periodike vjetore dhe se kjo ndreqje bën që gjendja e likuiditeteve cash në deklaratën Vetting të jetë 0 (zero), çka përputhet me deklarimin e subjektit në këtë deklaratë.

Lidhur me likuiditetet e deklaruara nga bashkëshorti i subjektit

9.12. Në DPV-në e vitit 2013 personi i lidhur ka deklaruar gjendje të ardhurash cash, të krijuara nga puna ndër vite, prej vitit 1998, në shumën 4.000.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2015 ka deklaruar pakësim të gjendjes së të ardhurave cash (blerje automjeti dhe shpenzime të ndryshme familjare), shuma 1.900.000 lekë. Në DPV-në e vitit 2016 ka deklaruar pakësim të kursimeve në shumën 1.300.000 lekë. Bazuar në këto deklarime rezulton se në datën 31.12.2016, bashkëshorti i subjektit ka pasur gjendje likuiditeti *cash* shumën 800.000 lekë¹⁰⁰, ndërkohë që në deklaratën *Vetting*, dorëzuar në datën 30.1.2017, nuk ka deklaruar gjendje likuiditetesh cash jashtë sistemit bankar. Gjithashtu, në deklaratat periodike të viteve 2017 dhe 2018 nuk janë deklaruar prej tij shtesa apo pakësime të likuiditeteve *cash*.

9.13. Sa më sipër, me anë të pyetësorit nr. 2, subjektit iu kërkuan shpjegime lidhur me shumën 800.000 lekë që rezulton gjendje në datën 31.12.2016. Në përgjigje, subjekti deklaroi se shuma prej 800.000 lekësh është shpenzuar në vitin 2014, por është harruar të deklarohet si shpenzim nga bashkëshorti për atë vit. Ky fakt është sqaruar në shpjegimet e dhëna pranë ILDKPKI-së në vitin 2016. Komisioni konstatoi se në procesverbalin e mbajtur në ILDKPKI datë 29.1.2016, i pyetur lidhur me gjendjen cash, subjekti ka deklaruar se shuma prej 4.000.000 lekësh vazhdon të jetë në banesë dhe pasi ta depozitojë në bankë do të paraqesë vërtetimin bankar. Kjo shumë është akumuluar me të ardhurat e bashkëshortit, veprimtarisë private shitje me pakicë (dyqan) me prindërit dhe më pas në emër të tij, si dhe punë të ndryshme private.

9.14. Më tej, në procesverbalin e mbajtur në datën 23.2.2016, subjekti deklaroi se është pakësuar ndër vite dhe se deri në datën 31.12.2014 gjendja ka qenë 3.200.000 lekë. Subjekti deklaroi se ka harruar të deklarojë në vitin 2014 shpenzimet në shumën 800.000 lekë nga gjendja cash e bashkëshortit. Gjatë vitit 2015 është pakësuar sërish, pakësim të cilin do e deklarojë në vitin pasardhës. Aktualisht gjendja cash është depozituar në bankë, në shumën 1.300.000 lekë. Subjekti ka paraqitur vërtetimin e “ABI Bank”, datë 22.2.2016, që vërteton këtë depozitim.

¹⁰⁰Nga shuma 4.000.000 lekë janë zbritur shumat e deklaruara si pakësim (1.900.000 lekë dhe 1.300.000 lekë).

9.15. Duke qenë se deklaratimet e subjektit në procesverbalet e ILDKPKI-së janë kontradiktore, Komisioni, për përlllogaritjen e likuiditeteve cash, u bazua vetëm në deklaratat periodike vjetore të subjektit.

9.16. Nga faktet e analizuara më lart, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, i interpretuar në lidhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës, me qëllim që të paraqesë shpjegime apo prova të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, në lidhje me konstatimin se: Ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit pranë ILDKPKI-së, lidhur me deklaratimet e gjendjeve cash, pasi në procesverbalin e mbajtur në datën 29.1.2016, subjekti fillimisht deklaroi se gjendja cash prej 4.000.000 lekësh (akumuluar me të ardhurat e bashkëshortit) është ende në banesë, ndërkohë që në procesverbalin e mbajtur në datën 23.2.2016 deklaroi se shuma prej 4.000.000 lekësh është pakësuar ndër vite, deri në datën 31.12.2014 gjendja cash ka qenë në vlerën 3.200.000 lekë. Gjatë vitit 2015 është pakësuar sërish dhe aktualisht gjendja cash është në shumën 1.300.000 lekë.

9.17. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se në momentin që ka përpiluar deklaratën Vetting nuk ka pasur gjendje cash. Pasi është konsultuar me bashkëshortin sqaron se deklarimi i saktë është ai i dhënë pranë ILDKPKI-së në datën 23.2.2016. Gjendja cash ka qenë pasuri personale e bashkëshortit dhe është administruar prej tij, për këtë arsye nuk ka qenë e saktë në deklarimin e datës 29.1.2016. Në fund të vitit 2014 nuk kishte deklaruar pakësimin e shumës 800.000 lekë dhe gjatë vitit 2015 kjo gjendje cash ishte pakësuar sërish dhe më 23.2.2016 ka qenë në vlerën 1.300.000 lekë.

9.18. Mosedeklarimi i pakësimit të gjendjes cash pranë ILDKPKI-së, në datën 23.2.2016, ka qenë një pakujdesi e bashkëshortit, por pa pasur si qëllim fshehjen e pasurisë apo burimit të saj. Në përfundim, subjekti, duke referuar për analogji në vendimin nr. 20/2019 të Kolegjit, deklaroi se kjo pasaktësi nuk mund të çojë në marrjen e masës disiplinore.

Arsyetimi ligjor mbi faktet dhe ligjin e zbatueshëm

9.19. Komisioni, duke pasur parasysh: (i) deklaratimet e subjektit të rivlerësimit në deklaratën e pasurisë për procesin kalimtar, *Vetting*; (ii) raportin e hollësishëm të ILDKPKI-së, deklaratat periodike dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja; (iii) provat shkresore të administruara nga Komisioni sipas neneve 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (iv) shpjegimet dhe provat e dërguara nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit administrativ dhe gjatë seancës dëgjimore, arsyeton se pretendimi i subjektit nuk mund të merret në konsideratë në analizën financiare për sa kohë që ky pakësim nuk është deklaruar në deklaratën periodike vjetore përkatëse, por çmon të theksojë se subjekti e ka deklaruar vullnetarisht këtë pasaktësi në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së në datën 23.2.2016, në përgjigje të pyetjes nr. 12 - nëse ka për të deklaruar pasuri, detyrime, biznes apo interesa të padeklaruara më parë në deklaratat periodike vjetore dhe se kjo ndreqje bën që gjendja e likuiditeteve cash në deklaratën Vetting të jetë zero, çka përputhet me deklarimin e subjektit në këtë deklaratë.

Lidhur me adresat e banimit të subjektit të rivlerësimit

9.20. Në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2007, deri në deklaratat periodike vjetore të vitit 2012, subjekti ka deklaruar se banon në adresën: lagjja “****”, Lushnjë. Në DPV-të e viteve 2013 dhe 2014 ka banuar në adresën: lagjja “****”, Lushnjë, pallati mbi “Raiffesien Bank”, Lushnjë. Në DPV-në e vitit 2015, nuk ka deklaruar adresë banimi. Në deklaratën Vetting dhe DPV-të e viteve 2016 - 2018, ka banuar në adresën: lagjja “****” Lushnjë, rruga “****”, p. ***. Më tej, në përgjigje të pyetësorit standard¹⁰¹, subjekti ka deklaruar se ku ka banuar nga momenti që ka marrë detyrën e në vazhdimësi¹⁰², adresa të cilat u analizuan nga Komisioni dhe nuk rezultuan problematika.

Hetim në lidhje me apartamentin në pronësi të prindërve të bashkëshortit të subjektit

9.21. Duke qenë se në procesverbalin mbi shpjegimet e dhëna nga subjekti pranë ILDKPKI-së në datën 29.1.2016, në përgjigje të pyetjes: “Saktësoni numrin e telefonit në përdorim dhe adresën e saktë të banimit, si edhe pronësinë e apartamentit ku banoni”, subjekti deklaroi se: “Jetojmë në apartamentin në pronësi të prindërve të bashkëshortit në lagjen “***”, pallati mbi ‘Raiffeisen Bank’, kati ***. Në pallat gjithashtu kemi marrë në katin e ***-të një hyrje me qira 13.000 lekë/muaj”. Ndërkohë që rezultoi se subjekti nuk ka deklaruar në deklaratat periodike dhe në pyetësorin standard se ka pasur në përdorim apartamentin në pronësi të prindërve të bashkëshortit. Për këtë arsye, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime lidhur me mospërputhjet e këtyre deklarimeve, si dhe i kërkoi të paraqesë dokumentacion ligjor në lidhje me pronësinë e apartamentit të prindërve të bashkëshortit. Në përgjigje të pyetësorit nr. ***, subjekti deklaroi se është një lapsus në mënyrën e të shprehurit në procesverbalin e mbajtur pranë ILDKPKI-së, ka jetuar dhe vazhdon të jetojë në një banesë me qira në lagjen “****”, pallati mbi “Raiffeisen Bank”, k. ***, por duke qenë se jeton në të njëjtin pallat me prindërit e bashkëshortit, të dyja adresat i ka paraqitur për njoftime të mundshme. Gjatë gjithë periudhës së bashkëjetesës dhe martesës, subjekti deklaroi se ka jetuar e ndarë nga prindërit e bashkëshortit dhe se ekonomia ka qenë e ndarë. Gjatë ditës, për shkak të afërsisë së banesave, dhe për shkak se në atë periudhë (në vitin 2016) ka qenë me lejelindje, mund të ketë qëndruar në banesën e prindërve të bashkëshortit gjatë ditës në orare të ndryshme, por nuk ka jetuar apo bashkëjetuar me ta. Për të provuar deklaratimet e tij, subjekti paraqiti: (i) kontratë sipërmarrjeje datë 16.8.2002, me palë shtetasit M.H. dhe K.P.; (ii) kontratë shitjeje nr. ***, datë 30.6.2015, me palë shitëse A. dhe B.D. dhe blerës K.P.; (iii) faturat për kryerjen e pagesave të apartamentit të mësipërm nga shtetasi K.P., pranë Bankës së Kursimeve të datave 16.8.2002, në vlerën 2.000 USD, 27.8.2002 në shumën 9.000 USD, 21.2.2003, në shumën 10.000 USD, 31.10.2003 në shumën 8.000 USD, pagesa në favor të shoqërisë “****” sh.p.k.

9.22. Referuar dokumenteve të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, rezultoi se kontrata e porosisë, datë 16.8.2002, është lidhur mes sipërmarrësit të përfaqësuar nga znj. M.H. dhe

¹⁰¹ E-mail datë 17.10.2019, ora 4:58.

¹⁰² (i) periudha nëntor 2007 - dhjetor 2011, ka banuar në adresën: lagjja “****”, Lushnje, në banesën e prindërve; (ii) periudha janar 2009 - qershor 2009, si dhe për periudhën dhjetor 2010 - korrik 2011 ka banuar në adresën: lagjja “****”, Gjirokastrë, në banesën e marrë me qira nga vlera e qirasë 5.000 lekë/muaj. Subjekti deklaroi se nuk ka pasur kontratë qiraje, por ka paraqitur deklaratën noteriale nr. ***, datë 16.12.2019, të shtetasit A.N. (pronari i shtëpisë); (iii) në periudhën shtator 2011 - maj 2012 ka banuar në adresën pranë ***, Gjirokastrë, banesë e marrë me qira nga shtetasja L.Ç. për një vlerë 5.000 lekë/muaj; (iv) periudha janar 2012 dhe aktualisht, banon në lagjen “****”, pallati mbi “Raiffeisen Bank”, Lushnje, banesë me qira në pronësi të z. E.B. (janar 2012 deri në momentin e transferimit në Lushnje në maj 2012, ka vazhduar të jetojë në ditë të veçanta edhe në banesën e marrë me qira në Gjirokastrë).

porositësit K.P. për apartamentin me sip. 120 m², ndodhur në shëtitoren “****”, mbi godinën e Bankës së Kursimeve, me çmim 36.000 USD (kësti I: 2.000 USD, paguar në momentin e nënshkrimit të kontratës; kësti II: 19.000 USD, do të likuidohet në datën 15.9.2002; kësti III: 12.000 USD do të likuidohet në datën 15.12.2002; kësti IV: 3.000 USD do të likuidohet në momentin e dorëzimit të apartamentit). Më tej, është lidhur kontrata e shitjes nr. ***, datë 30.6.2015, mes shitësit A.D.dhe palës blerëse K.P. për apartamentin me sip. 132.5 m², në rrugën “****”, me çmim 36.000 USD. Në këtë kontratë citohet se sipas kontratës së sipërmarrjes datë 16.8.2002, të lidhur me znj. M.H., blerësi ka paguar shumën 29.000 USD dhe në momentin e nënshkrimit të kontratës së shitjes do të paguante shumën e mbetur prej 7.000 USD. Sipas faturës urdhërderdhje datë 16.8.2002, në Bankën e Kursimeve nga z. K.P. në favor të shoqërisë “****” sh.p.k. është likuiduar vlera prej 2.000 USD. Me faturën datë 27.8.2002, urdhërderdhje në Bankën e Kursimeve, është likuiduar vlera prej 9.000 USD. Me faturën datë 31.10.2003, është likuiduar vlera prej 8.000 USD.

9.23. Nga analizimi i dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti, por dhe hetimi i Komisionit, vërehet se: (i) sipërfaqja e apartamentit në kontratën e porosisë datë 16.8.2002 është 120 m², ndërkohë që në kontratën e shitjes nr. ***, datë 30.6.2015, rezulton 132.5 m² dhe, më tej, në lidhje me regjistrimin e këtij apartamenti në ZVRPP, vërehet se në kontratën e shitjes apartamenti rezulton me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, ndërkohë, referuar dokumentacionit në Agjencinë e Kadastrës, apartamenti rezulton me nr. pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***; (ii) kontrata e porosisë, datë 16.8.2002, është lidhur mes sipërmarrësit të përfaqësuar nga znj. M.H. dhe porositësit K.P. ndërkohë që kontrata e shitjes nr. ***, datë 30.6.2015, është lidhur me palë shitëse A.D. dhe palë blerëse K.P.; (iii) sipas kontratës së shitjes në vitin 2015 rezulton se z. A.D. e ka blerë këtë apartament me anë të kontratës nr. ***, datë 5.7.2004, ndërkohë që po në të njëjtën kontratë, lidhur me çmimin e paguar i referohet kontratës së sipërmarrjes mbi të cilën është paguar një pjesë e shumës.

9.24. Në lidhje me mospërputhjet e konstatuara, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit me anë të pyetësorit nr. 06 , në përgjigje të të cilit subjekti deklaroi sa vijon: (i) Konstatimet lidhur me sipërfaqen e banimit kanë të bëjnë me zmadhimin e sipërfaqes së ballkonit të apartamentit. Lidhur me ndryshimin e të dhënave të pasurisë mund të jetë një lapsus pasi në bazë të dokumentacionit “vërtetim nga dokumenti hipotekor” dhe kartelës së pasurisë së paluajtshme, rezulton se apartamenti është i regjistruar me numër pasurie ***, z. k. ***, vol. ***, f. ***, e njëjtë si në kontratën e shitjes; (ii) ndërmjet palëve porositëse dhe sipërmarrëse, pas lidhjes së kontratës së porosisë ka pasur mosmarrëveshje lidhur me punimet e kryera dhe pagesën e kështit të fundit të banesës. Në vitin 2004 shtetasja M.H., pa zgjidhur mosmarrëveshjen me shtetasin K.P. apo kontratën e lidhur me të dhe pa i kthyer shumën e paguar deri në ato momente për apartamentin i ka shitur këtë apartament shtetasës P.R., dhe kjo e fundit më pas ia ka shitur shtetasit A.D. Familja e z. K.P. ka jetuar në këtë apartament që në përfundimin e tij, në vitin 2004, ndërsa shtetasit P.R. dhe A.D. nuk e kanë poseduar asnjëherë apartamentin; (iii) kontrata e lidhur në vitin 2015 është në vazhdimësi të kontratës së porosisë së lidhur në vitin 2002, ndërmjet palëve K.P. dhe M.H. Në vitin 2015, pas zgjidhjes së mosmarrëveshjes ndërmjet palëve, është lidhur kontrata e shitjes duke paguar pjesën e mbetur të detyrimit sipas kontratës së porosisë së vitit 2002. Duke qenë se banesa figuronte e regjistruar në emër të shtetasit A.D., kontrata është lidhur me këtë shtetas, si pronari i banesës.

9.25. Nga hetimi i Komisionit rezultoi se pranë zyrës së noterit publik A.K.¹⁰³ është lidhur kontrata e shitblerjes së apartamentit nr. *** rep., datë 23.6.1993, me palë shitëse Komisioni i Privatizimit të Rrethit Lushnjë dhe palë blerëse K. dhe Xh.P. (prindërit e bashkëshortit të subjektit) për apartamentin me sip. 56 m² (dhomë e kuzhinë), ndodhur në lagjen “****”, pallati nr. ***, kati ***, hyrja ***, me çmim 7.450 lekë. Shlyer me mandatin nr. ***, datë 5.6.1993.

9.26. Komisioni vëren se në deklaratën Vetting subjekti ka deklaruar si adresë: “Lagjja ‘***’, rruga ‘***’, pallati ***, Lushnjë”, ndërkohë që në pyetësonin standard ka deklaruar se që nga muaji janar 2012 e në vazhdim, ka banuar në lagjen “****” pallati mbi “Raiffeisen Bank”, Lushnjë. Nga kontrolli në Google Maps, rruga “****” nuk rezulton pranë “Raiffeisen Bank”. Në këto kushte, Komisioni, me anë të pyetësorit nr. 5¹⁰⁴, kërkoi shpjegime nga subjekti nëse bëhet fjalë për të njëjtën adresë. Në përgjigje¹⁰⁵ subjekti shpjegon se pallati mbi “Raiffeisen Bank” ndodhet në rrugën “****” dhe bëhet fjalë për të njëjtën adresë. Bashkëlidhur pyetësorit subjekti dorëzoi foto nga Google Maps, si dhe dy foto (të pallatit dhe të rrugës), nga ku rezulton se poshtë pallatit ku ndodhet “Raiffeisen Bank” ndodhet një tabelë treguese me emrin e rrugës “****”.

*Lidhur me pasuritë në lagjen “****”, Lushnjë*

9.27. Referuar dokumentacionit të administruar nga ASHK Lushnjë¹⁰⁶, z. P.Sh. (babai i subjektit), në cilësinë e blerësit, ka lidhur kontratën nr. ***, datë 26.1.1996, për blerjen e apartamentit me sip. 60.7 m², në vlerën 6.120 lekë. Rezulton se në emër të shtetasve K., G. dhe Natasha Shallapi figuron e regjistruar pasuria e llojit apartament me sip. 60.7 m² (banesë përdhese, një kat, sip. ndërtese 44 m²) me nr. ***, e ndodhur në z.k. ***, në lagjen “****”, Lushnjë, me pjesë respektive 4/6, 1/6 dhe 1/6. Sipas vërtetimit hipotekor, kjo pasuri është përfituar me anë të dëshmisë së trashëgimisë nr. ***, datë 27.2.2019, pasi babai i subjektit ka ndërruar jetë. Më tej, me anë të deklaratës noteriale nr. *** kol., datë 28.2.2019, subjekti i rivlerësimit deklaron se është trashëgimtare ligjore e z. P.Sh. dhe heq dorë nga pretendimet për pronësinë mbi procedurat e legalizimit të objektit lloji truall + ndërtesë (shtesë anësore banimi 1 kat në godinë ekzistuese) me sip. 44.5 m², me nr. ***, e ndodhur në z. k. ***, në lagjen “****”, Lushnjë. Sipas vërtetimit hipotekor nr. ***, datë 29.3.2019, kjo pasuri është regjistruar në emër të shtetasve K. dhe G.Sh.

9.28. Në përfundim, Komisioni vlerëson se nuk u konstatuan problematika lidhur me adresat e banimit të subjektit të rivlerësimit dhe se u dhanë shpjegime shteruese në lidhje me konstatimet gjatë hetimit administrativ.

Konkluzioni i Komisionit në lidhje me rivlerësimin e pasurisë

Në përfundim të shqyrtimit të kriterit të pasurisë, trupi gjykues i Komisionit çmon se, duke arsyetuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit dhe duke vënë në balancë vlerën e kësaj pamjaftueshmërie nga personi i lidhur/bashkëshorti i subjektit, në shumën 1.648.646 lekë, për krijimin jo vetëm të pasurive të deklaruara në DPV-në e vitit 2013 (përpara martesës ligjore),

¹⁰³Shkresa protokolluar në Komision me nr. *** prot., datë 7.12.2020.

¹⁰⁴E-mail datë 25.1.2021, ora 10:05.

¹⁰⁵E-mail datë 28.1.2021, ora 9:42.

¹⁰⁶Shkresa nr. ***, datë 10.12.2020.

por edhe të blerjes së pasurive të tjera dhe kryerjes së shpenzimeve përpara vitit 2013, të shtrira të gjitha këto në një periudhë 13-vjeçare (2001 – 2013), faktet dhe provat rrethore të krijojnë bindjen se kjo mungesë nuk mund të kualifikohet në asnjë prej situatave të parashikuara në pikat 1 dhe 3, të nenit 61, të ligjit nr. 84/2016 dhe të përbëjnë për pasojë një shkak për vendosjen e masës disiplinore të shkarkimit nga detyra. Për këtë arsye, Komisioni konkludon se subjekti ka arritur një nivel të besueshëm të vlerësimit të pasurisë.

B. KONTROLLI I FIGURËS

1. Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK) ka kryer kontrollin e figurës së subjekti të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016. Për këtë qëllim DSIK-ja ka dërguar një raport me shkresën nr. *** prot., datë 3.2.2021, deklasifikuar plotësisht me vendimin nr. ***, datë 15.2.2021, të KDZH-së, për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016.

Me shkresën nr. *** prot., datë 2.11.2017, është përcjellë në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit raporti për kontrollin e figurës për subjektin e rivlerësimit Natasha P. Prifti (Shallapi), me konstatimin për përshtatshmëri në vazhdimin e detyrës.

2. Në vijim është përcjellë raporti i përditësuar për kontrollin e figurës¹⁰⁷, sipas të cilit, informacionet e ardhura nga autoritetet verifikuese në kohështrirje gjatë periudhës së rivlerësimit bëjnë me dije se për subjektin e rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi), disponohen të dhëna mbi përfshirjen e saj në veprimtari të kundërligjshme shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës. Në vlerësim të të dhënave që disponohen rezulton se informacionet e ardhura nga ana e autoriteteve verifikuese janë thjesht në kuadrin e sinjalizimeve dhe nuk ka tregues apo të dhëna që të evidentojnë implikimin e subjektit në më shumë se një rast.

3. Në konfirmim të konstatimit fillestar për përshtatshmëri në vijimin e ushtrimit të detyrës për subjektin e rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi), DSIK-ja vlerëson që për rastin në fjalë konkluzioni të mbetet në Komision nën dritën e informacioneve të tjera që mund të disponojë si pjesë e gjetjeve/konstatimeve të dala nga procedurat e hetimit administrativ që po kryhen ndaj subjektit të rivlerësimit.

4. Komisioni kërkoi shpjegime nga subjekti në lidhje me raportin e përditësuar të DSIK-së, ku duket se disponohen të dhëna në kuadrin e sinjalizimeve për përfshirjen në veprimtari të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës. Subjekti i rivlerësimit, në shpjegimet dhe provat me shkrim dhe gjatë seancës dëgjimore në përgjigje të barrës së provës, deklaroi se: *“Lidhur me raportin e DSIK-së, sipas të cilit ka sinjalizime se jam e përfshirë në veprime të kundërligjshme, shfaqur në formën e shpërdorimit të detyrës, vetëm në një rast, dua të deklaroj se gjatë gjithë periudhës së ushtrimit të detyrës e kam ushtruar atë me përgjegjshmëri dhe duke zbatuar në çdo rast ligjin. Nuk mund të hamendësoj se çfarë rasti i*

¹⁰⁷Me kërkesë nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit shkresa nr. *** prot., datë 8.4.2020.

referohet raporti i DSIK-së dhe ku e bazon këtë konkluzion, por deklaroj se në çdo rast kam zbatuar ligjin”.

Hetimi i kryer nga Komisioni mbi kontrollin e figurës

5. Në sajë të informacioneve të marra nga organet verifikuese, Komisioni i është drejtuar Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë¹⁰⁸ lidhur me procedimet penale në ngarkim të shtetasit L. Ç. Në përgjigje¹⁰⁹, Prokuroria ka vënë në dispozicion fashikujt e procedimit penal nr. ***, me të pandehur shtetasin L. Ç., për veprën penale “dhënia ndihmë për kalim të paligjshëm të kufirit”, parashikuar nga neni 298/2 i Kodit Penal. Rezulton se veprimet hetimore janë kryer nga prokurori A. H. Më tej, Prokuroria ka vënë në dispozicion fashikullin e procedimit penal nr. ***, me të pandehur shtetasin L. Ç., akuzuar për veprën penale “plagosje e rëndë me dashje”, parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal. Rezulton se veprimet hetimore janë kryer nga prokurori A. Ç.

6. Sa më sipër rezultoi me anë të e-mailit datë 11.1.2021, ora 16:27, subjekti i rivlerësimit u pyet nëse ka kryer veprime hetimore apo procedurale në funksion të përmbushjes së detyrës së tij si prokuror në ngarkim të shtetasit L. Ç., duke vënë në dispozicion të Komisionit të gjithë fashikujt e procedimit penal, në rast të kundërt, të paraqesë vërtetim nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Në përgjigje¹¹⁰, subjekti deklaroi se gjatë periudhës së ushtrimit të funksionit si prokuror në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, nuk ka kryer veprime hetimore apo procedurale në ngarkim të këtij shtetasi, fakt ky i vërtetuar me anë të vërtetimit nr. ***, datë 13.1.2021, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

7. Në sajë të informacioneve të marra nga organet verifikuese, Komisioni kërkoi informacion për procedimet penale në ngarkim të shtetasit B. A. Në përgjigje¹¹¹, Prokuroria bën me dije se nuk rezulton të jetë regjistruar ndonjëherë procedim penal me të pandehur këtë shtetas.

8. Më tej, Komisioni administroi nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë fashikujt e procedimit penal nr. ***, me të pandehur shtetasin E. P., akuzuar për veprën penale “prodhim dhe shitje e lëndëve narkotike”, parashikuar nga neni 283/1 i Kodit Penal, kryer nën rrethanën rënduese të parashikuar nga neni 50/ç, i Kodit Penal. Nga hetimi rezultoi se subjekti ka disponuar me urdhrin “Për regjistrimin e procedimit penal”, duke shënuar emrin e personit nën hetim E. P., ka kërkuar vleftësimin e arrestit në flagrancë dhe caktimin e masës së sigurimit “arrest me burg”, si dhe ka disponuar me urdhrin “Për kryerjen e veprimeve hetimore”. Në deklaratimet e mëvonshme i akuzuari ka deklaruar se lënda narkotike e sekuestruar në banesë i përket atij dhe se babai i tij nuk ka pasur dijeni për të. Duke qenë se rezulton i dënuar një herë, në deklaratimin e parë ishte shprehur se nuk kishte dijeni dhe hangari përdorej nga babai i tij, si dhe shpreh pendesë për veprën e kryer. Subjekti, në datën 22.12.2017, ka paraqitur kërkesën për kalimin në gjyq të çështjes penale me nr. ***, duke argumentuar se hetimet janë të plota.

¹⁰⁸Shkresë nr. *** prot., datë 17.12.2020.

¹⁰⁹Shkresë nr. *** prot., datë 31.12.2020.

¹¹⁰E-mail datë 13.1.2021, ora 17:52.

¹¹¹Shkresë nr. *** prot., datë 31.12.2020.

Gjykata, me vendimin nr. ***, datë 6.2.2018, ka vendosur dërgimin e çështjes për gjykim. Komisioni vlerëson se nuk evidentohen parregullsi nga subjekti i rivlerësimit gjatë hetimit të këtij procedimi penal.

9. Komisioni, gjithashtu, kërkoi informacion nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë¹¹² nëse shtetasi D. P. (vëllai i bashkëshortit të subjektit), me profesion avokat, ka qenë në cilësinë e përfaqësuesit ligjor të palëve gjatë hetimeve të zhvilluara nga subjekti i rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi), gjatë kohës që ushtron detyrën si prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Në përgjigje¹¹³, Prokuroria bën me dije se nga verifikimet e kryera rezultoi se z. D. P. ka qenë përfaqësues ligjor i viktimave në procedimet penale nr. *** dhe nr. ***. Subjekti i rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi) ka hequr dorë nga hetimi i këtyre procedimeve penale sipas Kodit të Procedurës Penale dhe vazhdimi i hetimeve i ka kaluar prokurorëve të tjerë.

10. Ndërkohë Komisioni kërkoi informacion pranë Prokurorisë¹¹⁴ dhe Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë¹¹⁵ lidhur me numrin e çështjeve që i janë ngarkuar shtetasit D. P. në cilësinë e përfaqësuesit ligjor kryesisht të palëve në periudhat 2012 - 2017. Me anë të shkresës nr. *** prot., datë 28.1.2021, Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë informon se nga verifikimi i kryer pranë zyrës së buxhetit nuk rezulton që ky shtetas të jetë thirrur kryesisht nga gjykata si përfaqësues ligjor i palëve ndërgjyqëse. Prokuroria Lushnjë, me shkresën nr. *** prot., datë 10.2.2021, informon se shtetasi D. P., në periudhën 2012 - 2017, është caktuar avokat mbrojtës i palëve në 6 raste. Në vlerësim të fakteve të paraqitura nuk rezultuan *indicie* për hetime të mëtejshme ndaj subjektit të rivlerësimit.

11. Në vijim të hetimit, Komisioni administroi shkresën nr. *** prot., datë 16.12.2020, nga Prokuroria e Përgjithshme¹¹⁶, nga ku rezultoi se në ngarkim të subjektit të rivlerësimit nuk ka të regjistruar procedime penale, mosfillim ose pushim, por rezultoi se për periudhën 2006 - 2020 janë regjistruar ankesat nr. *** e vitit 2016, e shtetasit L. R. dhe nr. ***, e vitit 2019, e shtetasit F. A. Pas analizimit të këtyre ankesave nuk janë konstatuar parregullsi nga subjekti. Ndërkohë, Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat, me anë të shkresës nr. *** prot., datë 22.6.2020, bën me dije se nuk rezulton të ketë procedim penal në ngarkim të subjektit, por rezulton një material kallëzues për të cilin është vendosur mosfillimi i procedimit penal¹¹⁷.

¹¹²Shkresë nr. *** prot., datë 17.12.2020.

¹¹³Shkresë nr. *** prot., datë 31.12.2020.

¹¹⁴Shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2021.

¹¹⁵Shkresë nr. *** prot., datë 25.1.2021.

¹¹⁶Komisioni kërkoi informacion më anë të shkresës nr. *** prot., datë 5.6.2020.

¹¹⁷Nga Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë është dërguar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat një kallëzim penal i shtetasit E. S. ndaj disa prokurorëve të Prokurorisë së Lushnjës: R. Z., Natasha Prifti dhe Ç. Sh. Nga rrethanat e parashtruara në këtë kallëzim rezulton se janë ngritur pretendime për mungesën e dokumenteve në një material hetimor të denoncuar nga kallëzuesi, pretendime lidhur me vendimmarrje të marra në kushte konflikti interesi dhe në mungesë të verifikimeve të plota të dokumenteve të kallëzuesit. Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat arsyeton se nuk është përpara elementëve të ndonjë vepre penale, konkrete, të parashikuara nga legjislati i penale, nuk ka kompetencë për shqyrtimin e pretendimeve të tilla dhe se ato duhet të shqyrtohen në rrugë gjyqësore në kuadër të ankimeve ndaj vendimmarrjeve përkatëse të prokurorëve. Në datën 14.4.2020 ka vendosur "Mosfillimin e procedimit penal" për materialin kallëzues nr. ***, datë 24.6.2019.

12. Sa më sipër, nga hetimi i Komisionit në lidhje me raportin e organeve verifikuese u konstatua se të dhënat e paraqitura nuk përputhen me situatën faktike të çështjeve të shqyrtuara dhe nuk rezultuan veprime apo mosveprime të subjektit të rivlerësimit, të cilat konfirmojnë informacionin e përcjellë nga organet verifikuese.

Konkluzioni në lidhje me kontrollin e figurës

Subjekti i rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi) ka plotësuar saktë deklaratën e kontrollit të figurës, nuk ka kontakte me persona të përfshirë në krimin e organizuar, në kuptim të pikës 15, të nenit 3, të ligjit nr. 84/2016 dhe ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b”, të nenit 59/1, të ligjit nr. 84/2016.

C. RIVLERËSIMI I AFTËSIVE PROFESIONALE

1. Sipas nenit 44 të ligjit nr. 84/2016, relatori përgatit relacionin për vlerësimin e aftësive profesionale, mbështetur në raportin e inspektorëve, informacionin e marrë nga burime të tjera, si dhe në kriteret e vlerësimit, të parashikuara në legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve ose prokurorëve dhe akteve të tjera ligjore.

2. Subjekti i rivlerësimit, në periudhën nëntor 2007- nëntor 2008, ka ushtruar funksionin e prokurores në stazh në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier. Në periudhën nëntor 2008 - korrik 2009 është emëruar në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Në periudhën korrik 2009 - tetor 2010 është komanduar në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Vlorë. Në periudhën tetor 2010 - maj 2012 ka ushtruar funksionin pranë Prokurorisë së Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë. Në maj të vitit 2012 deri aktualisht ushtron funksionin në Prokurorinë e Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.

3. Këshilli i Lartë i Prokurorisë, si organi ndihmës, ka përgatitur një raport për vlerësimin profesional të subjektit të rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi), bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: (i) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe të dhënave e dokumenteve të tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit dhe që janë paraqitur nga subjekti i rivlerësimit; (ii) pesë dosjeve penale të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; (iii) të dhënave në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme. Nga ku rezultoi sa vijon:

Aftësitë profesionale

Subjekti i rivlerësimit tregon korrektësi në zbatimin e ligjit dhe identifikimin e drejtë të normave ligjore të zbatueshme. Evidentohet se qëndrimet e subjektit janë mbështetur nga Drejtuesi i Prokurorisë dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Në vlerësimet e punës për vitet 2014, 2015 dhe 2016 të bëra nga Prokurori i Përgjithshëm rezulton se subjekti është vlerësuar “shumë mirë” për aftësitë profesionale.

Aftësitë organizative

Subjekti rivlerësimit, në periudhën e rivlerësimit 8.10.2013 – 8.10.2016, ka kryer detyrën e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Nga të dhënat statistikore rezulton se gjatë kësaj periudhe ka trajtuar gjithsej 319 materiale. Nga këto

materiale 124 janë mosfillime, 35 çështje të pushuara, 93 çështje të dërguara për gjykim, 125 çështje të pezulluara dhe tri akte të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ndjekjet penale brenda afateve dhe sipas kërkesave të ligjit procedural penal. Lidhur me efektivitetin në aspektin sasior në raport me kohëzgjatjen e trajtimit të çështjeve dhe kërkesave të ndryshme penale ka përballuar ngarkesën e punës, me efikasitet, duke qenë eficient dhe efektiv. Nga dosjet e vëzhguara konstatohet se janë të administruar rregullisht, materialet janë të vendosura në rend kronologjik, të njohin me faktin penal, me qëndrimin e prokurorit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe disponimin e gjykatës.

4. Nga verifikimi në Sektorin e Burimeve Njerëzore pranë Prokurorisë së Përgjithshme rezultoi se për periudhën e rivlerësimit, për subjektin Natasha Prifti (Shallapi) nuk është marrë asnjë masë disiplinore. Sektori Protokoll – Arkiv në Prokurorinë e Përgjithshme¹¹⁸ bën me dije se nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e kallëzimeve dhe procedimeve penale të Prokurorisë së Përgjithshme, rezulton se nuk ka çështje apo kallëzim penal të filluar ndaj subjektit të rivlerësimit. Ndërkohë, nga kontrolli i ushtruar në regjistrat e ankesave në Prokurorinë e Përgjithshme, në mënyrë manuale, për periudhën viti 2006 – 2019, rezulton se shtetasi L. R. ka paraqitur një ankesë ndaj subjektit të rivlerësimit lidhur me vendimin e mosfillimit të procedimit penal për materialin kallëzues nr. ***, të vitit 2016, të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, për veprën penale të parashikuar nga neni 130/a i Kodit Penal. Ankuesi pretendon se çështja nuk është shqyrtuar me profesionalizëm nga prokurori i çështjes Natasha Prifti (Shallapi). Kjo ankesë është marrë në shqyrtim nga Drejtoria e Kontrollit të Hetimit, Ndjekjes Penale, Përfaqësimit në Gjykim dhe Mbikëqyrjes së Ekzekutimit të Vendimeve Penale në Prokurorinë e Përgjithshme dhe pas kontrollit të ushtruar është arritur në konkluzionin se nuk ka shkaqe ligjore për shfuqizimin e vendimit datë 27.9.2016, për mosfillimin e procedimit penal të Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Ankuesit i është sugjeruar se nëse ka pretendime të mëtejshme kundër këtij vendimi, bazuar në nenin 291 të Kodit të Procedurës Penale, duhet të ushtrojë ankim në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë. Komisioni vëren se në vlerësim të fakteve të paraqitura nuk rezultuan *indicie* për hetime të mëtejshme ndaj subjektit të rivlerësimit.

Hetimi i kryer nga Komisioni

5. Pavarësisht raportit të dërguar nga KLGJ-ja , Komisioni kreu një hetim të pavarur në lidhje me tri dokumentet e përzgjedhura nga subjekti, pesë dosjet e shortuara sipas një shorti objektiv dhe ankesave të paraqitura pranë Inspektoratit të KLD-së. Pas analizimit të tyre u konstatuan këto problematika dhe u kërkuar shpjegime e prova për sa vijon:

5.1. Lidhur me procedimin penal nr. ***, regjistruar në datën 10.4.2015, për veprën penale “vjedhje e energjisë elektrike”, parashikuar nga neni 137/1 i Kodit Penal. Në funksion të hetimit të çështjes, më 10.4.2015, subjekti ka disponuar me urdhër delegimi për kryerjen e disa veprime hetimore me afat të përcaktuar. Në përfundim të hetimit, oficeri i policisë gjyqësore, në datën 25.6.2015, ka përpiluar relacionin “Mbi provat, faktet dhe mënyrën për përfundimin e hetimit të procedimit penal nr. ***, datë 10.4.2015” dhe bazuar në nenin 327/1

¹¹⁸Shkresë nr. *** prot., datë 5.6.2020.

të Kodit të Procedurës Penale ka sugjeruar pushimin e çështjes. Në datën 10.7.2014 (brenda afatit të hetimeve paraprake), subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes në mbështetje të germës “a”, të paragrafit 1, të nenit 328 dhe nenit 329 të Kodit të Procedurës Penale, duke arsyetuar se nga hetimi nuk u provua që fakti i kallëzuar ekziston. Komisioni vëren se për një periudhë prej 3 muaj e 20 ditë nuk është kryer asnjë veprim hetimor nga subjekti i rivlerësimit.

5.2. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij duke sqaruar se: *“Procedimi penal është regjistruar më 10.4.2015 dhe po në këtë datë është urdhëruar oficeri i policisë gjyqësore për kryerjen e veprimeve hetimore, të cilat janë kryer brenda afatit 3-mujor të përcaktuar në nenin 323 të Kodit të Procedurës Penale. Sqarojmë se procedimi në fjalë nuk është regjistruar me person nën hetim, pasi të dhënat paraprake të referuara nga Komisariati i Policisë Lushnjë nuk ishin të mjaftueshme për të krijuar dyshimin e arsyeshëm mbi atribuimin e përgjegjësisë penale një personi konkret. Po kështu, oficeri i policisë gjyqësore që ka referuar këtë material kallëzues, para referimit të tij në Prokurori ka kërkuar informacion shtesë nga OSHEE-ja në lidhje me abonentin e dyshuar për lidhje të paligjshme të energjisë elektrike. Administrimi i këtij informacioni dhe njëkohësisht ngarkesa në punë kanë ndikuar në regjistrimin e këtij procedimi penal disa kohë më pas nga regjistrimi si material kallëzues e kryerjen më pas të veprimeve të nevojshme hetimore”.*

5.3. Arsyetimi ligjor i Komisionit - trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka vendosur pushimin e çështjes brenda afatit të hetimeve paraprake (datë 10.7.2014) dhe pavarësisht se nga subjekti i rivlerësimit për një periudhë prej 3 muaj e 20 ditë nuk është kryer asnjë veprim hetimor, kjo nuk përbën shkak autonom për shkarkimin e tij, por mbetet një element i cili është konsideruar nga trupi gjykues në vlerësimin tërësor që i është bërë kriterit të aftësisë profesionale për subjektin e rivlerësimit.

6. Më tej, Komisioni kërkoi informacion pranë Inspektoratit të Lartë të Drejtësisë në lidhje me ankesat e paraqitura ndaj subjektit të rivlerësimit dhe masat disiplinore të marra ndaj tij, nga periudha 2006 e deri më sot. Pas administrimit të shkresës nr. *** prot., datë 7.12.2020, rezultoi se ndaj subjektit janë depozituar 2 ankesa me nr. *** prot., datë 30.10.2020, e shtetasit F. A. (trajtuar më poshtë, në seksionin e denoncimeve nga publiku) dhe nr. *** prot., datë 10.6.2020, e shtetasit K. N., si dhe nuk administrohen të dhëna lidhur me masa disiplinore të dhëna ndaj tij.

6.1 Lidhur me ankesën e shtetasit K. N. – pas shqyrtimit të këtij procedimi penal konstatohet se subjekti i rivlerësimit me vendimin e datës 15.3.2018 ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, duke arsyetuar se nga faktet dhe rrethanat e parashtruara në kallëzim nuk gjendet para elementeve të veprës penale “pushtim të tokës”, apo të ndonjë vepre tjetër penale për të cilën organi i Prokurorisë duhet të fillojë hetimet. Nga materialet e referuara rezulton se kallëzuesi K. N. pretendon pronësinë mbi një sipërfaqe toke, pronësi të cilën e pretendon mbi bazën e një vendimi gjyqësor për vërtetim fakti pronësie. Vërtetimi i faktit nuk është një nga mënyrat e fitimit të pronësisë, përcaktuar nga Kodi Civil dhe legjislacioni në fuqi. Për më tepër, bazuar në nenin 193 të Kodit Civil, vërtetimi i faktit të pronësisë nuk regjistrohet. Në këto kushte, duke qenë se kallëzuesi sipas ligjit nuk ka fituar ende pronësinë mbi pronën e pretenduar, nuk mund as të pretendojë se është cenuar nga të tretë mbi pronën e tij.

6.2. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. ***, datë 10.5.2018, ka vendosur prishjen e vendimit të mosfillimit dhe vazhdimin e hetimeve, duke përcaktuar edhe veprimet hetimore që do të kryhen. Sipas gjykatës, subjekti nuk ka hetuar në lidhje me: (i) pretendimet e ngritura nga kallëzuesi (me këqyrje apo aktekspertimi) nëse prona në të cilën po bëhen punime është e njëjtë me pronën e pretenduar prej tij; (ii) cili është posedimi faktik ligjor i të kallëzuarit, referuar dokumentacionit ligjor të tij, a po dëmtohet ajo pronë apo jo; (iii) subjekti që po e përdor materialin inert nga ajo pronë shtetërore aktualisht a është i licencuar dhe a e ushtron sipas ligjit këtë lloj veprimtarie apo jo. Bazuar në vendimin e gjykatës, subjekti i rivlerësimit ka regjistruar kallëzimin penal nr. ***, për veprën penale “pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal, kundër shtetasit B. Ç.

6.3. Ndërkohë që çështja është kthyer në prokurori për hetime të mëtejshme, Komisioni vëren se subjekti ka kryer hetimet si vijon: (i) është këqyruar vendi i ngjarjes dhe të gjitha aktet përbërëse të praktikës së regjistrimit të pasurisë së paluajtshme në ASHK, nga ka rezultuar se pasuria nr. *** e llojit “karrerë” dhe nr. *** e llojit “kullotë”, regjistruar në pronësi të të kallëzuarit, shtetasit B. Ç. Këtë sipërfaqe toke shoqëria “****” sh.p.k. e ka marrë me qira me qëllim për të ushtruar aktivitetin që ushtron, gërmime dheu. Më tej, nga aktekspertimi topografik rezulton se ka pasaktësi lidhur me pronën e pretenduar dhe nuk mund të përcaktohet nëse midis pronave që i përkasin kallëzuesit dhe asaj të pretenduar nga kallëzuesi ka mbivendosje, pasi është e papërcaktuar në planvendosje.

6.4. Sa më sipër, subjekti ka arsyetuar se referuar rrethanave të faktit dhe provave të administruara nuk rezulton të jetë para elementëve të ndonjë vepre penale dhe procedimi penal duhet të pushohet. Nga hetimet e kryera ka rezultuar se sipërfaqja e tokës së pretenduar nga kallëzuesi është në pronësi të shtetasit B. Ç., përfituar nga babi i tij me vendim të KKKP-së Lushnjë në vitin 1999, e regjistruar pranë ZVRPP-së Lushnjë. Vërtetimi i faktit të pronësisë nga kallëzuesi nuk e të bën atë pronar, në këto kushte, nuk mund të pretendojë se është cenuar nga të tretë. Lidhur me veprën penale “shpërdorim të tokës”, neni 199 i Kodit Penal parashikon se përbën kundërvajtjet penale dhe dënohet me gjobë ose burgim deri në gjashtë muaj. Për sa kohë fakti i kallëzuar përbën kundërvajtje administrative, konkludohet se nuk përbën vepër penale, në këto rrethana ky procedim penal duhet të pushohet.

6.5. Vendimi i pushimit është ankimuar përsëri nga kallëzuesi K.N. dhe Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në vendimin nr. ***, datë 1.10.2019, arsyeton se: “Në rastin në gjykim, proceduralisht prokurori ka vepruar drejtë në kushtet kur ka vendosur pushimin e procedimit penal pasi: *së pari* në çështjen penale të pushuar është proceduar për një kundërvajtje penale të parashikuar nga neni 199 i Kodit Penal, “shpërdorim i tokës” me marzh dënimi deri në 6 muaj burg; por *së dyti* gjykata, pasi analizoi provat e mbledhura nga organi i akuzës gjatë hetimeve paraprake vlerëson se hetimet nuk janë të plota dhe shteruese dhe, për rrjedhojë, prokurori nuk duhet të dispononte për pushimin e çështjes pa kryer më parë minimalisht edhe disa veprime hetimore të rëndësishme në procedime të këtij lloji e për këtë kategori vepre penale. Në përfundim, gjykata arsyeton se prokurori duhet të kryejë të gjitha veprimet e pakryera hetimore të listuara në vendimin e gjykatës, si dhe veprimet e tjera hetimore që mund të dalin në dinamikën e hetimeve paraprake, duke u dhënë përgjigje në mënyrë shteruese të gjitha paqartësive të ngritura në kallëzim.

6.6. Nga faktet e analizuara më lart, Komisioni kërkoi shpjegime në lidhje me konstatimin se: “Organi i akuzës, pa marrë parasysh se kush është kallëzues i veprës penale, nëse raportohet një fakt penal, ka detyrimin ligjor të ushtrojë hetim mbi çdo lloj çështje që ndiqet kryesisht, në këto kushte: (i) referuar vendimit datë 15.3.2018, për mosfillimin e procedimit penal, subjekti nuk ka kryer veprimet e nevojshme hetimore lidhur me pronësinë e pasurisë së paluajtshme të pretenduar, si dhe nuk ka analizuar gjitha pretendimet e ngritura në kallëzim; (ii) gjithashtu, referuar vendimit datë 7.5.2019 të subjektit të rivlerësimit ‘Për pushimin e procedimit penal’, si dhe akteve të administruara në fashikullin hetimor nuk rezulton të jenë vlerësuar në mënyrë të drejtë: (i) detyrat e lëna nga gjykata; (ii) pretendimet e kallëzuesit; dhe (iii) rrethanat e faktit të pretenduara si fakte penale”.

6.7. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se: *“Është disponuar me vendim për mosfillimin e procedimit penal nr. ***, pasi është vlerësuar se rasti në fjalë nuk ka pasur nevojë për hetime të thelluara, fakt i cili u vlerësua i tillë edhe nga Gjykata e Apelit Vlorë me vendimin nr. ***, datë 4.12.2019. Materiali kallëzues i depozituar nga kallëzuesi K. N. ka qenë i plotë dhe përmbante informacion të hollësishëm në lidhje me faktin penal të pretenduar prej tij. Për këtë arsye, duke qenë se nga vetë materiali kallëzues rezultonte se kallëzuesi nuk kishte të drejta pronësie mbi pronën objekt kallëzimi (pasi dispononte vetëm një vërtetim fakti pronësie) u vlerësua se nuk gjendeshim para cenimit të pronës së këtij të fundit dhe, për rrjedhojë, nuk kishte elementë të veprës penale “pushtimi i tokës”, parashikuar nga neni 200 i Kodit Penal. Në bazë të nenit 193 të Kodit Civil parashikohet se vërtetimi i faktit nuk mund të regjistrohet. Vërtetimi i faktit nuk përbën titull pronësie, pra, pavarësisht se kallëzuesi mund të pretendojë pronësinë mbi një pronë, duhet fillimisht ta fitojë atë sipas ligjit dhe të pretendojë më pas që i kanë cenuar të drejtat e pronësisë”.*

- Lidhur me shkaqet e ngritura nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me vendimin nr. ***, datë 1.10.2019, për prishjen e vendimit të pushimit të prokurorit, subjekti pretendon se nuk janë të drejta dhe për këtë shkak edhe vendimi është ankimuar në Gjykatën e Apelit Vlorë, e cila ka konstatuar gjithashtu se hetimet janë të plota dhe ka vendosur të pranojë ankimin e prokurorit. Gjatë hetimit të këtij procedimi penal janë kryer gjithë veprimet e lëna nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në vendimin nr. ***, datë 10.5.2018 (është këqyrrur vendi i ngjarjes, është kryer aktekspertimi topografik, është administruar dokumentacioni ligjor i pronës së të kallëzuarit, është kërkuar informacion pranë Inspektoratit shtetëror të mjedisit, pyjeve dhe ujërave për subjektin që kryente punimet) pra, nga ana e prokurorit janë kryer veprimet hetimore të lëna nga gjykata dhe gjithë veprimet e cenuara të nevojshme për një hetim të plotë.
- Pavarësisht se nga gjykata e shkallës së parë në dy raste është vendosur prishja e vendimit të mosfillimit dhe më pas kthimi për hetime të mëtejshme të këtij procedimi penal (pasi ishte vendosur pushimi i çështjes) nga gjykata më e lartë, ajo e Apelit Vlorë është gjetur i drejtë ankimi i prokurorit dhe, për këtë arsye, është lënë në fuqi vendimi i pushimit të çështjes. Pra, edhe pse nga ana e prokurorisë janë kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në përfundim të tyre sërish është vendosur pushimi i çështjes, pasi fakti nuk përmbante elementë të ndonjë vepre penale. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti vendimet nr. ***, datë 1.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë dhe vendimin nr. ***, datë 4.12.2019, të Gjykatës së Apelit Vlorë.

6.8. Vlerësimi ligjor i Komisionit - pasi u analizuan provat e paraqitura, Komisioni konstaton se Gjykata e Apelit Vlorë, me vendimin nr. ***, datë 4.12.2019, ka vendosur ndryshimin e vendimit nr. ***, datë 1.10.2019, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, duke lënë në fuqi vendimin e pushimit të çështjes, pasi fakti nuk përmbante elementë të ndonjë vepre penale. Subjekti, pasi ka kryer veprimet hetimore të urdhëruara nga gjykata, ka arritur në të njëjtin konkluzion për mosfillimin e procedimit penal. Në këto kushte rezulton se vendimi i subjektit i datës 15.3.2018 për mosfillimin e procedimit penal, në thelb ka qenë i drejtë.

6.9. Në përfundim, Komisioni vëren se lidhur me këtë procedim penal nuk rezultojnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

7. Në kuadër të hetimit të mëtejshëm, lidhur me kriterin e vlerësimit profesional, Komisioni përzgjodhi 12 procedime penale të hetuara nga subjekti i rivlerësimit Natasha Prifti (Shallapi) gjatë procesit të rivlerësimit. Pasi u analizuan dosjet e administruara¹¹⁹, Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me procedimet sa vijon:

7.1 Procedimi penal nr. *** - në përfundim të hetimeve subjekti ka konkluduar se nisur nga praktika gjyqësore dhe në kuptim të nenit 150 të Kodit Penal, ka vepër penale të dëmtimit me dashje të pronës, kur pasojat e veprimeve të autorit mbi pasurinë, si element i anës objektive nuk janë të lehta. Nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, vlera jo e lehtë është përcaktuar mbi 30.000 lekë. Në këtë rast mungon pasoja si element i anës objektive që kërkon shprehimisht neni 150 i Kodit Penal dhe fakti i kallëzuar nuk parashikohet nga ligji si vepër penale. Në datën 27.3.2015 është vendosur mosfillimi i procedimit penal bazuar në germen “ç”, të nenit 290, të Kodit të Procedurës Penale.

7.2. Subjektit të rivlerësimit iu kërkua të paraqesë dokumentacion provues mbi praktikën e përdorur nga Gjykata dhe Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, lidhur me përcaktimin e masës mbi 30.000 lekë për pasojat e shkaktuara mbi pasuritë.

7.3. Në cilësinë e provës, subjekti paraqiti vendimin nr. ***, datë 5.10.2020, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, vendimin datë 19.6.2013, të prokurorit P. Ç., për pushimin e çështjes dhe vendimet e mosfillimit të procedimit penal në datat 25.8.2013, 25.9.2018, 3.2.2020, të prokurores R. Z. Në këto vendime konkludohet se vlera e dëmit nën 30.000 lekë vlerësohet si pasojë e lehtë. Në përfundim të shpjegimeve, subjekti deklaroi se ky interpretim ka gjetur zbatim jo vetëm në Prokurorinë dhe Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, por në çdo prokurori dhe gjykatë me juridiksion të përgjithshëm.

7.4. Vlerësimi ligjor i Komisionit – pasi u analizuan provat e paraqitura, Komisioni vëren se subjekti provoi bindshëm se nga praktika gjyqësore e Gjykatës dhe Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, vlera jo e lehtë materiale është përcaktuar në kufirin mbi 30.000 lekë, për të cilën për ekonomi gjyqësore nuk investohen organet e prokurorisë dhe gjykatës.

8. Procedimi penal nr. *** – Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në bazë të akteve të referuara nga Komisariati i Policisë Lushnjë ka regjistruar kallëzimin penal të paraqitur nga shtetasja T. H. ndaj shtetasit B. M., duke e akuzuar se ka ushtruar dhunë ndaj saj.

¹¹⁹Shkresa nr. *** prot., datë 10.2.2021.

8.1. Pasi është realizuar ekspertimi mjekoligjor rezultoi se të kallëzuesja konstatohen shembje të kokës, dëmtime të shkaktuara me mjet të fortë mprehës dhe këto dëmtime hyjnë në kategorinë e dëmtimeve të parëndësishme. Subjekti i rivlerësimit ka konkluduar se dëmet e shkaktuara hyjnë në kategorinë e atyre dëmtimeve të kategorizuara si rrahje, vepër kjo e parashikuar në nenin 90 të Kodit Penal. Në bazë të nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale, vepra penale “dëmtime të tjera me dashje”, e parashikuar nga neni 90 është vepër për të cilën i dëmtuari ka të drejtë të paraqesë personalisht kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Pra, prokuroria nuk është organ i legjitimuar për të kryer hetime në lidhje me këtë vepër penale. Me anë të vendimit “Për mosfillimin e procedimit penal”, datë 3.10.2016, subjekti vendosi mosfillimin e procedimit duke arsyetuar bazuar në germën “ç”, të nenit 290, të Kodit të Procedurës Penale.

8.2. Komisioni vëren se shtetasja T.H. ka paraqitur kallëzim penal në datën 8.9.2016, ndërkohë që ekspertiza mjekësore e kërkuar nga subjekti është kryer në datën 13.9.2016, pra katër ditë pas denoncimit. Sipas këtij raport rezulton se nga kartela klinike nr. ***, datë 9.9.2016, ora 09:00, e Repartit të Kirurgjisë në Spitalin Rajonal Lushnjë, kallëzuesja ka qenë e shtruar me diagnozën “Kontuzio capitis”. Sa rezulton, përputhet me deklaratimet e kallëzueses, e cila deklaroi se ka qëndruar 4 ditë në spital. Ndërkohë që në dosjen penale nuk administrohet dokumentacion lidhur me pretendimet e kallëzueses mbi shtrimin dhe kurimin e saj në Spitalin Rajonal Lushnjë dhe subjekti është mjaftuar vetëm me ekspertizën mjekoligjore.

8.3. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij, duke sqaruar se: *“Mjeku ligjor i ngarkuar me kryerjen e ekspertimeve mjekoligjore ka detyrimin që para se të përgatisë aktekspertimin mjekoligjor të ekzaminojë fizikisht të dëmtuarin, si dhe çdo dokument mjekësor që ekziston për këtë të fundit, përfshirë këtu dhe kartelën mjekësore. Kjo praktikë tashmë e konsoliduar nga ana e ekspertëve të IML-së, është ndjekur edhe në rastin në fjalë, ku mjeku ligjor në aktin e përgatitur prej tij në pjesën përshkruese ka pasqyruar se në arritjen e konkluzionit mbi kategorizimin e dëmtimeve është bazuar, ndër të tjera, edhe në kartelën mjekësore të të dëmtuarës. Pra, nuk ka qenë i nevojshëm administrimi i kartelës për sa kohë që këqyrja e saj është kryer nga vetë eksperti. Rastet kur prokurori i çështjes çmon si të domosdoshëm administrimin e kartelave mjekësore janë kur i dëmtuari nuk pajtohet me përfundimet e arritura nga mjeku ligjor dhe vlerësohet nga prokurori se ka vend për kryerjen e një riekspertimi mjekoligjor. Në të tilla raste, kartela administrohet për t’ua vënë në dispozicion grupit të ekspertëve që do të kryejnë riekspertimin. Gjithashtu, data në të cilën eksperti mjekoligjor ka përgatitur aktekspertimin nuk korrespondon me datën në të cilën e dëmtuara është larguar nga spitali. Ky fakt (largimi nga spitali) pasqyrohet në kartelën mjekësore. Megjithatë, edhe nëse do të pranohet si të mirëqenë se kjo datë i korrespondon datës së daljes nga spitali të të dëmtuarës, sërish nuk ndodhemi para dëmtimeve të lehta, pasi koha e qëndrimit është 4 ditë, ndërkohë që plagosja e lehtë kërkon shtrim në spital/humbje të aftësisë për punë në masën mbi 9-të ditë. Nëse kallëzuesja do të kishte pretendime mbi kategorizimin e dëmtimeve të pësuarat prej saj, kjo e fundit do të kishte paraqitur ankim ndaj vendimit të mosfillimit të prokurorit”.*

8.4. Analiza ligjore e Komisionit – pasi u analizuan shpjegimet e subjektit, Komisioni vëren se mjeku ligjor në aktin e përgatitur prej tij, në arritjen e konkluzionit mbi kategorizimin e dëmtimeve është bazuar, ndër të tjera, edhe në kartelën mjekësore të të dëmtuarës. Pra, nuk ka

qenë i nevojshëm administrimi i kartelës për sa kohë që këqyrja e saj është kryer nga vetë eksperti. Rastet kur prokurori i çështjes çmon si të domosdoshëm administrimin e kartelave mjekësore, janë kur i dëmtuari nuk pajtohet me përfundimet e arritura nga mjeku ligjor dhe vlerësohet nga prokurori se ka vend për kryerjen e një riekspertimi mjekoligjor. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegime bindëse lidhur me sa konstatohet, në këto kushte konkludohet se janë kryer dhe administruar të gjitha veprimet e nevojshme hetimore lidhur me këtë procedim penal.

DENONCIMET NGA PUBLIKU

1. Në Komision, për subjektin e rivlerësimit Natasha Shallapi, janë administruar 8 denoncime nga publiku. Në 3 prej këtyre denoncimeve ngrihen pretendime për dhënien e vendimeve të padrejta dhe nuk përmbahen fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit të subjektit, respektivisht: (1) denoncimi nr. *** prot., datë 14.1.2017, i shtetases A. P., e cila ankohet për dhënien e një vendimi të padrejtë; (2) denoncimi nr. *** prot., datë 30.7.2018, i shtetasit A. B., i cili ankohet për disa subjekte rivlerësimi lidhur me vendime dhe gjykime të padrejta. Komisioni vëren se denoncuesi nuk ka paraqitur ndonjë pretendim apo *indicie* konkrete ndaj subjektit; (3) denoncimi nr. *** prot., datë 10.9.2020, i shtetases A. J., e cila ankohet për mungesë transparence, profesionalizmi, shkelje të afateve ligjore dhe mashtrim në përpjekje për ndryshim të numrit të kallëzimit penal nga nr. ***, datë 15.10.2018 në nr. ***.

2. Komisioni, pasi mori në shqyrtim ankesat e mësipërme, konstaton se pretendohen fakte që kanë lidhje me korrektësinë e vendimeve dhe themelin e çështjeve të gjykuara nga subjekti i rivlerësimit, rrethana të cilat nuk mund të shqyrtohen nga Komisioni, sipas përcaktimit të pikës 2, të nenit E, fjalja e fundit, faqja 60 nga 64 e Aneksit të Kushtetutës dhe pikës 4, të nenit 73, të ligjit nr. 96/2016.

3. Ndërkohë që Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me denoncimet nr. *** prot., datë 7.11.2019, nr. *** prot., datë 12.11.2019 dhe nr. *** prot., datë 2.11.2019, të shtetasve O. dhe F. A., të cilët pretendojnë se subjekti i rivlerësimi ka kërkuar ryshfet në vlerë 5.000.000 lekë (ndërkohë në denoncimin tjetër pretendohet vlera prej 5.000 euro) për kryerjen e hetimeve dhe ka vendosur pushimin e çështjes penale të kallëzuar nga denoncuesit.

4. Pas administrimit të kallëzimit penal nr. ***¹²⁰, Komisioni vëren se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në datën 17.5.2020, ka regjistruar kallëzimin penal të shtetasit F. A. në ngarkim të shtetasit A. U., për veprën penale “plagosje e lehtë me dashje”, parashikuar nga neni 89 i Kodit Penal. Në datën 2.6.2020, subjekti ka vendosur mosfillimin e procedimit penal, pasi fakti nuk përbën veprë penale. Në vendimin e mosfillimit, subjekti arsyeton se: *“Në bazë të nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale, vepra penale ‘dëmtime të tjera me dashje’, e parashikuar nga neni 90, është veprë për të cilën i dëmtuari ka të drejtë të paraqesë vetë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Pra, Prokuroria nuk është organi i legjitimuar për të kryer hetime në lidhje me këtë veprë penale”*. Ndërkohë që, nëse i referohemi pikës 1, të nenit 59 përcaktohet se: *“Ai që është dënuar nga veprat penale të parashikuara nga nenet 90, 91,*

¹²⁰Shkresa nr. *** prot., datë 31.12.2020.

92, 112, paragrafi i parë, 119, 119/b, 120, 121, 122, 125, 127 dhe 254 të Kodit Penal, ka të drejtë të paraqesë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit”. Ndërsa në nenin 90 parashikohet se: “Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i padituri në palët private ...”. Komisioni vëren se subjekti është kontradiktor në referimin që i bën bazës ligjore dhe arsytimit të tij lidhur me faktin nëse prokuroria është apo jo organi i legjitimuar për të kryer hetime në lidhje me veprat penale të parashikuara nga neni 90 i Kodit Penal.

5. Për sa rezulton, subjekti paraqiti shpjegimet e tij duke sqaruar se në vendimin e mosfillimit si në pjesën arsyetuese dhe në pjesën e dispozitivit, nenet përkatëse janë referuar drejt nga ana e tij. Në bazë të nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale, vepra penale “dëmtime të tjera me dashje”, e parashikuar nga neni 90 i Kodit Penal, është vepër për të cilën i dëmtuari ka të drejtë të paraqesë vetë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Pra, Prokuroria nuk është organi i legjitimuar për të kryer hetime në lidhje me këtë vepër penale. Vendimi i mosfillimit i referohet nenit 90 të Kodit Penal, ku parashikohet vepra penale “dëmtime të tjera me dashje”, e cila sipas nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale ndiqet drejtpërsëdrejti në gjykatë nga i dëmtuari akuzues.

6. Analiza ligjore e Komisionit - referuar vendimit të mosfillimit, subjekti arsyeton se: “Në bazë të nenit 59/1 të Kodit të Procedurës Penale, vepra penale “dëmtime të tjera me dashje”, e parashikuar nga neni 90, është vepër për të cilën i dëmtuari ka të drejtë të paraqesë vetë kërkesë në gjykatë dhe të marrë pjesë në gjykim si palë për të vërtetuar akuzën dhe për të kërkuar shpërblimin e dëmit. Pra, Prokuroria nuk është organi i legjitimuar për të kryer hetime në lidhje me këtë vepër penale”. Ndërkohë që, në referencën që ka bërë subjekti në nenin 90 parashikohet se: “Mosmarrëveshja mund të parashtrohet nga prokurori pranë njëres prej gjykatave në mosmarrëveshje ose nga i padituri në palët private ...”. Pra, nuk është e qartë nëse prokuroria është apo jo organi i legjitimuar për të kryer hetime në lidhje me veprat penale të parashikuara nga neni 90 i Kodit Penal. Në përfundim, Komisioni konkludon se referimi kontradiktor që bën subjekti në bazën ligjore nuk ka ndikuar në vendimmarrjen e procedimit penal.

7. Komisioni, më tej, kërkoi shpjegime lidhur me denoncimet nr. *** prot., datë 10.12.2019 dhe nr. *** prot., datë 10.12.2019, të shtetasit A. K., i cili ndër të tjera, ankohet për subjektin e rivlerësimit për shkelje të etikës profesionale, zvarritje në proces dhe pranim/shkëmbim dhuratash, favoresh apo parash nga persona të përfshirë në krimin e organizuar. Denoncuesi kundërshton aktekspertimin gjatë hetimeve dhe pretendon pavlefshmërinë e tij.

8. Komisioni, pas administrimit të fashikujve të kallëzimit penal nr. ***¹²¹, vëren se Prokuroria pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë ka paraqitur pranë kësaj gjykate kërkesën për dërgimin në gjyq të çështjes penale në ngarkim të të pandehurit A. K., i akuzuar për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/3 i Kodit Penal dhe i pandehuri T. R., i akuzuar për veprën penale “falsifikim të dokumenteve”, parashikuar nga neni 186/1 i Kodit Penal. Në thelb të këtij konflikti është një çështje pronësie. Nga hetimet e prokurorisë,

¹²¹Shkresë nr. *** prot., datë 31.12.2020.

rezultoi se denoncuesi A. K., me detyrë hartograf pranë ZVRPP-së Lushnjë, ka qenë i ngarkuar për saktësimin/korrigjimin e sipërfaqes së pasurisë së pretenduar (nr. ***, z.k. ***) dhe me veprimet e tij ka konsumuar elementet e veprës penale “falsifikim të dokumenteve”, si dhe ka shkelur dispozitat e ligjit nr. 7843, datë 13.7.1994, “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, i ndryshuar.

9. Të pandehurit kanë kundërshtuar hetimet e kryera nga Prokuroria, duke ngritur pretendime në lidhje me pavlefshmërinë e akteve të hetimeve paraprake, papërdorshmëri të provave, si dhe marrjen e provave të tjera në hetim. Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, në vendimin nr. ***, datë 21.2.2018, çmon se në rastin konkret, hetimet e kryera nga organi i prokurorisë janë të plota dhe janë kryer të gjitha veprimet e nevojshme hetimore në kuadër të grumbullimit të provave për të provuar faktin penal në ngarkim të të pandehurit. Në përfundim vlerësoi se kërkesa e paraqitur nga subjekti, i plotëson të gjitha elementët formale për vlefshmërinë e saj dhe duhet të pranohet duke vendosur dërgimin në gjyq të çështjes penale.

10. Lidhur me pretendimet për zvarritje të procesit, Komisioni vëren se procedimi penal është regjistruar në datën 13.9.2016 dhe në datën 19.9.2016 subjekti ka disponuar me urdhërdelegimi për kryerjen e veprimeve hetimore. Në datën 3.10.2017 është nxjerrë urdhri “Për regjistrimin e emrit të personit që i atribuohet vepra penale” dhe në datën 15.11.2017 është nxjerrë vendimi “Për njoftim akuze dhe marrjen e personit si të pandehur”, të cilët nga aktet në dosje rezultojnë të kenë marrë dizeni dhe po në këtë datë janë njoftuar për përfundimin e hetimeve. Më tej, në datën 30.12.2017, subjekti ka vendosur për dërgimin e çështjes në gjyq, afat ky brenda parashikimeve të nenit 324 të Kodit të Procedurës Penale, nga momenti i regjistrimit të emrit që i atribuohet vepra penale.

11. Ndërkohë, lidhur me pretendimet e tjera të paraqitura në denoncim pranim/shkëmbim dhuratash, favoresh apo parash nga persona të përfshirë në krimin e organizuar, denoncuesi nuk ka paraqitur asnjë provë apo *indicie*, ku mbështeten akuzat e ngritura ndaj subjektit.

12. Denoncuesi, ndër të tjera, pretendon se subjekti ka çuar për gjykim një çështje në ngarkim të tij për t’u hakmarrë, pasi si ish-punonjës i ZVRPP-së Lushnjë nuk ka regjistruar një pronë të vjehrrit të subjektit K.P., e fituar me privatizim të ndërmarrjes shtetërore dhe vendim gjykate, e cila ndodhet në lagjen “****”, në afërsi të zonës ish-*** Lushnjë. Kjo pronë me sipërfaqe të konsiderueshme ishte regjistruar në sistemin e vjetër të regjistrimit dhe nuk ishte kaluar në sistemin e ri për t’u pajisur me dokument pronësie. Komisioni kërkoi shpjegime lidhur me sa pretendohet.

13. Subjekti, në përgjigje të barrës së provës, paraqiti shpjegimet e tij duke sqaruar se gjykata e themelit në vendimin nr. ***, datë 5.6.2020, e ka gjetur të drejtë akuzën e ngritur nga prokurori dhe, për këtë arsye, ka vendosur deklarinim fajtor të tij. Për të rrëzuar çdo pretendim të denoncuesit subjekti ka vënë në dispozicion shkresën nr. *** prot., datë 17.5.2021, lëshuar nga ASHK-ja Lushnjë, nga e cila rezulton se pranë këtij institucioni nuk është paraqitur asnjëherë asnjë kërkesë nga shtetasi K.P. për regjistrimin e pasurisë së pretenduar nga denoncuesi. Denoncuesi nuk ka ushtruar detyrën e kryeregjistruesit pranë ish-ZVRPP-së Lushnjë, por ka qenë në pozicionin e specialistit - hartograf. Bazuar në Kodin e Procedurës Penale, i pandehuri apo palët kanë të drejtë të kërkojnë përjashtimin e prokurorit në rast se ka arsye për të menduar se ky i fundit është i njëanshëm. Nuk rezulton që një kërkesë e tillë të jetë

ngritur nga i pandehuri as gjatë hetimeve paraprake as në gjykim, çka çon në përfundimin e arsyeshëm se hakmarrja është kryer nga i pandehuri dhe jo nga prokurori në formë ndëshkimi për dërgimin e tij për gjykim.

14. Analiza ligjore e Komisionit - Komisioni vëren se Gjykata e Rrethit Gjyqësor Lushnjë, me anë të vendimit nr. ***, datë 5.6.2020, e ka gjetur të drejtë akuzën e ngritur nga prokurori dhe, për këtë arsye, ka vendosur deklarinimin fajtor të tij. Referuar shkresës nr. *** prot., datë 17.5.2021, të lëshuar nga ASHK-ja Lushnjë, të paraqitur nga subjekti në cilësinë e provës, Komisioni vëren se në emër të vjehrrit të subjektit K.P., nuk figuron e regjistruar ndonjë pronë në lagjen “****”, në afërsi të zonës ish-*** Lushnjë, sikundër pretendohet në denoncim. Për sa rezulton, nuk provohet asnjë prej akuzave të ngritura në denoncim ndaj subjektit të rivlerësimit.

15. Sa rezulton, Komisioni konstaton se në mbështetje të nenit 53 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, vlerësohet se këto denoncimet e trajtuara nuk përmbajnë fakte apo rrethana që mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit profesional për subjektin e rivlerësimit.

16. Si konkluzion, Komisioni, në vlerësimin tërësor të kriterit të aftësive profesionale, vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), është “e aftë” pasi ka treguar cilësi të pranueshme në punë, gjykim të drejtë, ka respektuar të drejtat e palëve dhe është eficient në masë të pranueshme.

KONKLuzion Përfundimtar

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit të çështjes, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), ka plotësuar së bashku kushtet e mëposhtme:

- a. ka arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. ka arritur nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. ka arritur nivel kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale, sipas parashikimit të germës “c”, të pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

Për këto arsye,

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, z. Gerrit Sprenger dhe referuar germës “a”, të pikës 1, të nenit 58 dhe pikës 1, të nenit 59, të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

V E N D O S I:

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Natasha Prifti (Shallapi), prokurore në Prokurorinë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Lushnjë.
 2. Vendimi, i arsytuar me shkrim, i njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerit Publik dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, 30 ditë pas përfundimit të seancës dëgjimore dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016.
 3. Ndaj këtij vendimi mund të ushtrohet ankim në Kolegjin e Posaçëm të Apelit nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit.
 4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.
- Ky vendim u shpall në Tiranë, në datën 28.5.2021.

ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES

Roland ILIA
Kryesues

Etleda ÇIFTJA
Relatore

Alma FASKAJ
Anëtare

Sekretare gjyqësore
Olsida Goxhaj